

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5608
E hënë, 22 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Veseli: Shkëmbimi i territoreve nuk është opsion



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com


facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI

Uniteti i treguar për ushtri të vazhdojë edhe për dialogun me Serbinë

- Beteja rreth dialogut është personalizuar së tepërmi



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka bërë me dije se pozita dhe opozita duhet ta vazhdojnë edhe për çështje të tjera madhore unitetin e treguar për transformimin e FSK-së në ushtri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se një

unitet i tillë për procesin e dialogut me Serbinë do ta mundësonte rrumbullakimin më të shpejtë të shtetndërtimit të Kosovës. Sipas Maliqit, çështja e dialogut me Serbinë është personalizuar. Ai ka shprehur skepticizëm se zgjedhjet e reja do të

mund të sillnin ndonjë situatë tjetër në skenën politike. Sipas Maliqit, zgjedhjet janë gjithnjë të mirëseardhura nëse ato çojnë drejt daljes nga kriza dhe premtojnë rezultatin më deciziv në favor të partive në pushtet ose të atyre në opozitë

AKTUALE

ÇFARË KËRKON MINISTRI I JASHTËM TURK NË BALLKAN? F. 12

Shkruan: Bedri ISLAMI



LDK-JA KËRKON MOBILIZIM TË STRUKTURAVE PËR ZGJEDHJE TË REJA F. 7

'LOJË PINGPONG' E PROKURORISË DHE GJYKATËS ME RASTIN E VETERANËVE TË UÇK-së F. 7

EKONOMI

DHJETË KOMPANI NGA KOSOVA MARRIN PJESË NË PANAIRIN SIAL 2018 F. 8

QEVERIA KËRKON PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT F. 9

KULTURË

NJË YLL I RI PO I NGJITET SKENËS SË MUZIKËS F. 12



SPORT

S'KA FITUES NË DERBI. GJILANI BEFASOI FERONIKELIN F. 16

Vetëvendosje kërkon vetting për AKI-në dhe policinë



Përveç gjyqësorit dhe prokurorisë, shteti i Kosovës ka nevojë urgjente për reforma dhe vetting edhe në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe në Policinë e Kosovës (PK). Kështu ka deklaruar të dielën anëtari i Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, në një konferencë për medie, në të cilën ka folur lidhur me skandalin ku dyshohet se djali i drejtorit të AKI-së, Shpend Maxhuni, është arrestuar pasi i ishin gjetur armë dhe narkotikë

Në fshatin Gllarevë zbulohet lapidari i dëshmorit të kombit Haki Morina



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Majko: Kosova të ketë kujdes në dialogun me Serbinë

TIRANË, 21 TETOR - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Pandeli Majko, ka mirëpritur miratimin në parim të tri ligjeve për shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri, dhe ka thënë se siguria kombëtare e Shqipërisë dhe Kosovës janë të pandashme. Ish-kryeministri, tash ministër i Diasporës në Qeverinë e

Shqipërisë, në një intervistë për KP ka thënë se ushtria e Kosovës e bën më të fortë edhe Shqipërinë. "Është çështje e një forme ligjore e cila duhet të mbyllet përfundimisht dhe Kosova të ketë të drejtë të blejë armatim të rëndë, ashtu siç blejnë të gjitha kombet dhe shtetet natyrshëm të Evropës, sepse Kosova është shtet i cili po

ndërton politikën e vet të sigurisë kombëtare. Ajo që është e rëndësishme ta them unë është që siguria kombëtare e Shqipërisë dhe Kosovës janë të pandashme. Në qoftë se Kosova ftohet apo sëmuret, ne andej kollitemi dhe anasjelltas", ka thënë Majko. Majko ka komentuar zhvillimet e fundit politike në Kosovë, duke

thënë se Kosova duhet të ketë kujdes në dialogun Kosovë-Serbi, sepse serbët kanë prodhuar një politikë mjaft të qëndrueshme dhe janë pjesë e një loje që nuk fillon dhe mbaron në Beograd. "Në qoftë se serbët kanë ndryshuar, le të shohim, por unë nuk hy te njerëzit që mendojnë se serbët janë një komb që ndryshojnë



shpejt. Ata janë njerëz që kanë prodhuar një politikë goxha të qëndrueshme dhe janë pjesë e një shahu që nuk fillon dhe mbaron në Beograd. Megjithatë, të shohim", theksoi Majko.

Veseli: Shkëmbimi i territoreve nuk është opsion

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në një intervistë për agjencinë shtetërore të lajmeve gjermane, "DPA", ka kundërshtuar mundësinë e shkëmbimit të territoreve me Serbinë, duke thënë se shkëmbimi i territoreve nuk është opsion. Veseli e ka ftuar Serbinë që ta njohë Kosovën shtet të pavarur



vetëm dy orë larg Adriatikut dhe vetëm dy orë gjysmë larg Portit të Selanikut në Greqi", ka shtuar Veseli. Ai ka thënë se Kosova synon që në Ballkan të jetë vendi më atraktiv për investitorët.

Po ashtu, Veseli ka paralajmëruar heqjen e pengesave burokratike dhe lehtësimet tatimore për investitorët e huaj. Më tutje, Veseli ka folur për zhvillimet e fundit në Maqedoni dhe marrëdhëniet me Greqinë fqinje, që sipas tij janë të rëndësishme edhe për Kosovën.

Ndërsa sa i përket Serbisë, Veseli e ka ftuar atë që ta njohë Kosovën si shtet të pavarur.

Veseli ka kundërshtuar mundësinë e shkëmbimit të territoreve me Serbinë, duke thënë se "shkëmbimi i territoreve nuk është opsion".

PRISHTINË, 21 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në një intervistë për agjencinë shtetërore të lajmeve gjermane, "DPA" ka thënë se shpreson që pas tërheqjes së Bundeswehrit gjerman nga kampi më i madh i kësaj ushtrie në Prizren, në këtë qytet do të vijnë investitorë nga firmat gjermane. "Caku im është që sa më

shumë firma gjermane të vijnë në Kosovë dhe sa më pak kosovarë ta lëshojnë vendin. Për neve është e rëndësishme që të hapen vende pune në mënyrë që njerëzit tanë të qëndrojnë në vend", ka thënë Veseli.

Kampi i deritashëm i Bundeswehrit është mbyllur pas 20 vitesh dhe në vend të tij po

hapet Parku i Inovacionit dhe Mësimi Profesional. Gjermania është duke e përkrahur këtë projekt.

Veseli ka qëndruar të enjten në Berlin ku mes tjerash është takuar edhe me kryetarin e Bundestagut,

Wolfgang Schauble. "Ne shpresojmë që investitorët gjermane në Prizren do të shtohen dhe jo vetëm aty por në tërë vendin tonë", ka deklaruar Veseli. "Kosova është një vend i vogël por në aspektin strategjik e pozicionuar mirë:

Si do të ndahet deti me Greqinë?

TIRANË, 21 TETOR - Sa e prek Shqipërinë nisma e Qeverisë greke për ta përdorur konceptin e 12 miljeve në hapësirën territoriale të saj në det? Kjo është pyetja që lind pas deklarës së kryeministrit Alexis Tsipras dhe ish-ministrit të Jashtëm, Kotzias.

"Top Channel" ka mësuar se mbi cilën linjë do të punohet. Ndërkohë që Greqia do të zgjerojë hapësirën e saj me 12 milje nga toka në det me Shqipërinë, aplikimi i kësaj norme është i pamundur, kjo për shkak se pavarësisht ligjit të brendshëm të një vendi, për



Hapësira detare që nuk ndahet nga Greqia e detit territorial deri 12 milje pasi distanca midis dy brigjeve është më e vogël se 24 milje. Në këtë zonë zbatohet ndarja sipas vijës së mesit të korrektuar.

ndarjen e kufirit mes dy vendeve vlejnë konventat ndërkombëtare.

E drejta e 12 miljeve është e drejtë ndërkombëtare në zbatim të konventës UNCLOS të vitit 1982. Shqipëria dhe Italia e kanë zgjidhur shpejt çështjen e hapësirës detare, kjo për shkak

se janë dy shtete përballë dhe hapësira mes tyre është më e madhe se 24 milje, kjo bën që mos të ketë mbivendosje të së drejtës së 12 miljeve. Por, Shqipëria dhe Greqia janë shtete në krah dhe këtu situata është më e komplikuar.

Në këtë pikë hyjnë negociatat dhe grupet negociatore tashmë janë përgatitur me argumentet. Disa prej argumenteve të palës shqiptare i ka mësuar edhe Top Channel. Dy grupet, pasi të marrin edhe lejen nga instancat më të larta, në rastin e Shqipërisë nga presidenti Ilir Meta do të ulen të

flasin mbi konventat. Kjo për shkak se për të ndarë detin konventa nuk merr parasysh sa e ke gjerësinë e detit territorial me ligje të brendshme, pra nëse e ke me ligj të brendshëm 0 milje, 6 milje apo 12 milje, konventa të thotë që pavarësisht gjerësisë që ti ke me ligjin tënd, kur të negociosh do përdorësh vijën e mesit, vija me distanca të barabarta nga vijat bazë të bregdetit të dy shteteve, por kjo vijë më pas modifikohet, duke pasur parasysh edhe rrethanat e veçanta të konfigurimit të bregdetit.

Ky modifikim nuk u mor parasysh në draft-marrëvesh-

jen e vitit 2009, por u aplikua në atë kohë vetëm vija e mesit. Top Channel ka mësuar edhe se cila është zona që do të ndahet sipas vijës së mesit. Është e gjithë hapësira me ngjyrën e verdhë që ndodhet e përcaktuar në këtë hartë. Me marrëveshjen, e re vija e mesit do të modifikohet për rrethanat e veçanta të konfigurimit të bregdetit duke i dhënë Shqipërisë avantazh në det territorial. Distanca nga brigjet midis Shqipërisë dhe Greqisë është më pak se 24 milje në të gjithë gjatësinë e detit territorial mes tyre, madje në Kanalin e Korfuzit ajo varion nga 1 deri në 6 milje detare.

Jeremiqi: Kosova mund të bashkohet me Shqipërinë

Beograd, 21 tetor - Kryetari i Partisë Popullore të Serbisë, Vuk Jeremiqi, ka thënë se presidenti serb, Aleksandër Vuçiq është duke përshpejtuar negociatat për demarkacionin e kufirit me Kosovën, në mënyrë që marrëveshja e Vuçiqit me

presidentin Hashim Thaçi, të finalizohet në katër muajt e parë të vitit 2019.

Siç raporton "FoNet", Jeremiqi ka thënë se "demarkimi i kufijve do të thotë se në anën tjetër të kufirit të mbetet 90 për qind e territorit të Kosovës, por edhe

pjesët jugore të Serbisë, të cilën shqiptarët e quajnë Lugina e Preshevës". Ai ka thënë se Kosova do të bëhet anëtare e plotë e Kombeve të Bashkuara, siç është Serbia sot dhe se nuk do të ketë pengesë në të drejtën ndërkombëtare për t'u

bashkuar me Shqipërinë. "Kur flas për Shqipërinë e madhe nuk flas për mendësh", ka thënë Jeremiqi.

Ish-shefi i diplomacisë serbe ka theksuar se Serbia mund të përballet me kërkesa të reja territoriale "nëse ajo sot pajtohet



që në paqe t'ia vizatojnë kufijtë e saj".

Lëvizja Vetëvendosje (LV) të dielën ka mbajtur konferencë për medie

Vetëvendosja kërkon vetting për AKI-në dhe policinë

Përveç gjyqësorit dhe prokurorisë, shteti i Kosovës ka nevojë urgjente për reforma dhe vetting edhe në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI) dhe në Policinë e Kosovës (PK). Kështu ka deklaruar të dielën anëtari i Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, në një konferencë për medie, në të cilën ka folur lidhur me skandalin ku dyshohet se djali i drejtorit të AKI-së, Shpend Maxhuni, është arrestuar pasi i ishin gjetur armë dhe narkotikë

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 TETOR - Deputeti dhe anëtari i Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Rexhep Selimi, ka thënë të dielën se institucionet e sigurisë së Kosovës kanë nevojë për reforma të mirëfillta. Në një konferencë me gazetarë, ai ka thënë se, përveç prokurorisë dhe gjyqësorit, është nevojë urgjente vittingu edhe në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë dhe në Policinë e Kosovës. "Kosova, përveç vittingut për gjyqësorin dhe prokurorinë, ka nevojë urgjente për vetting edhe në polici dhe në AKI. Në polici dhe në institucionet e tjera të sigurisë ka njerëz të mirë e të përkushtuar në punën që e kryejnë, ka njerëz patriotë dhe heronj, por ata njerëz mbi kokat e tyre kanë njerëz të paduhur për udhëheqje. Vërejtjet që i kemi për krerët e institucioneve të drejtësisë, nuk nënkuptojnë që të njëjtat i kemi për ata oficerë e policë të cilët janë të përkushtuar për ta kryer detyrën e tyre me nder, të cilët edhe jetën e rrezikojnë në mbrojtje të qytetarëve të Kosovës", ka deklaruar Selimi

duke folur për rastin e arrestimit të djalit të shefit të AKI-së, Shpend Maxhuni, që dyshohet se i është gjetur armë dhe narkotikë.

Selimi ka rikujtuar se procesin e vittingut në polici para disa vjetëve nuk e ka kaluar Shpend Maxhuni që tash është shef i AKI-së. Prandaj, sipas Selimit, është i domosdoshëm një vitting i hollësishëm për të gjitha institucionet e sigurisë dhe drejtuesit e tyre. Deputeti Selimi ka thënë se nëse jo shkarkimi, dorëheqja morale e Maxhunit do të ishte fillimi i reformës së nevojshme në drejtësi dhe në organet e sigurisë së Kosovës. "Dorëheqja, apo në mungesë të përgjegjësisë morale, shkarkimi i drejtuesve të tillë të institucioneve të sigurisë, do të ishte hapi i parë drejt reformës shumë të nevojshme në drejtësi dhe në organet e sigurisë në Kosovë", është shprehur Selimi. Megjithatë, sipas tij, një reformë e mirëfilltë në drejtësi, polici e AKI nuk do të mund të realizohet përderisa në krye të këtyre institucioneve janë emëruar njerëz me direktiva nga politika dhe të kontrolluar nga persona të caktuar në poli-



tikë. Selimi ka thënë se më e rëndë se arrestimi dhe fajësia e djalit të Maxhunit është tentativa e institucioneve të drejtësisë dhe të sigurisë për ta mbuluar të vërtetën.

Ai ka deklaruar se s'përputhja në mes të deklaratave të prokurorisë dhe të policisë për rastin "Maxhuni" janë prova se ka pasur tashmë ndërhyrje nga lart për ta deformuar ngjarjen. "Nuk jemi për ta denoncuar një rast të veçantë të izoluar, në rastin konkret rastin e krimit A. M., por për diçka më të rëndë, reagimin e institucioneve të drejtësisë dhe menaxhmentit të policisë në mbrojtje të krimit

apo, thënë më mirë, fshehje të krimit. Skandalet e tilla në Kosovë nuk janë as aksidente, as incidente, por pasoja direkte të kapjes së shtetit dhe vetë s'përputhja e deklaratimeve të rastin 'Maxhuni' janë dëshmi që këto ndërhyrje janë bërë nga lart. Kapësit e shtetit i kanë ndarë mirë hiset e veta në tortën e pushtetit. Pra, siç e thashë, i kanë ndarë se cilat institucione jo t'i udhëheqin, por t'i kontrollojnë", ka thënë Selimi.

Më tutje, ai ka vlerësuar se sot qytetarët e Kosovës jetojnë në një ambient të pasigurt. "Ky

ambient është i pasigurt jo pse është jashtë kontrollit por, përkundrazi, sepse është totalisht brenda kontrollit. Jo brenda kontrollit të institucioneve të sigurisë, por nën kontrollin e grupeve mafioze qoftë brenda, qoftë jashtë institucioneve të shtetit. Në një shtet kur prokurori arratiset e i akuzuar qeverisë, kush do ta mbrojë qytetarin? Në një shtet ku në emër të drejtësisë bëhen padrejtësitë më të mëdha, kush do ta mbrojë qytetarin?", është shprehur Selimi duke shtuar se qytetari është i pambrojtur dhe ka mbetur në mëshirën e kapësve të shtetit.



Haradinaj paralajmëron shkarkimin e zëvendësministrit Cena

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka paralajmëruar shkarkimin e Musa Cenës nga pozita e zëvendësministrit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, i cili është arrestuar nga policia nën dyshimin se ka marrë rryshfet dhe ka keqpërdorur detyrën zyrtare. Haradinaj ka thënë se Cena do të largohet nga Qeveria. "Në këto


raste po, lirim. Nëse aktakuza është për kohën e përgjegjësisë, po", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se organet e drejtësisë po e bëjnë punën e vet. "I përgëzojmë për punën e mirë", ka deklaruar ai.

Gjykata Themelore në Prishtinë ka kërkuar një muaj paraburgim për zëvendësministrin e Zhvillimit Rajonal, Musa Cena.

Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

Uniteti i treguar për ushtri të vazh

- Beteja rreth dialogut është personalizuar së tepërmi



Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka bërë me dije se pozita dhe opozita duhet ta vazhdojnë edhe për çështje të tjera madhore unitetin e treguar për transformimin e FSK-së në ushtri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se një unitet i tillë për procesin e dialogut me Serbinë do ta mundësonte rumbullakimin më të shpejtë të shtetndërtimit të Kosovës. Sipas Maliqit, çështja e dialogut me Serbinë është personalizuar. Ai ka shprehur skepticizëm se zgjedhjet e reja do të mund të sillnin ndonjë situatë tjetër në skenën politike. Sipas Maliqit, zgjedhjet janë gjithnjë të mirëseardhura nëse ato çojnë drejt daljes nga kriza dhe premtojnë rezultatin më deciziv në favor të partive në pushtet ose të atyre në opozitë

EPOKA E RE**Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 21 TETOR - Analisti politik Shkëlzen Maliqi i ka ftuar subjektet politike që unitetin e treguar në Kuvend, për votimin rreth transformimit të FSK-së në ushtri, ta vazhdojnë edhe për çështje të tjera me interes kombëtar. Ai ka deklaruar se konsensusi për çështjen e dialogut me Serbinë ndihmon në rumbullakimin e shtetndërtimit të Kosovës.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se bojkoti nuk është mjet që ndihmon në zgjidhjen e çështjeve madhore. "Ky lloj i unitetit dhe i përkushtimit do të duhej të ekzistonte edhe për

çështje të tjera që i përmendet, e që janë të po kësaj rëndësie për qëllimin e rumbullakimit të shtetndërtimit të Kosovës. Bojkoti nuk është mjet që ndihmon në zgjidhjen e çështjeve madhore, sepse bëhet fjalë për çështje që kërkojnë koncentrim të votës, e jo për thellimin e përçarjes dhe bllokadës së proceseve që pa dyshim i shpërfaq bojkoti", ka thënë Maliqi. Ai ka treguar se subjektet politike në shumë aspekte të procesit të dialogut me Serbinë kanë pajtime. "Nëse shihet se cilat janë qëndrimet e pozitës dhe të opozitës rreth vijave të kuqe që nuk mund të kapërcehen në dialogun me Serbinë dhe marrëveshjen finale, është e qartë se në vijat e trasha mes tyre ekzis-

ton pajtimi. Vetëm LV-ja sikur ka kushtëzime rreth dialogut që e kthen atë në fillim dhe nuk e shtyn drejt finalizimit. Po kështu, ekziston edhe bindja dhe pajtimi se çdo marrëveshje që arrihet në dialog duhet të aprovohet dhe ratifikohet nga Kuvendi, çka nënkupton se edhe mund të refuzohet nëse nuk e mbështet shumica", ka thënë ai.

Maliqi ka vlerësuar se çështja e dialogut me Serbinë është personalizuar. "Fatkeqësisht, e gjithë beteja rreth dialogut tani është personalizuar për së tepërmi sepse më shumë dalin në sipërfaqe smirat dhe inatet e ndërsjella të treshes Thaçi, Mustafa dhe Kurti, por edhe treshes tjetër Haradinaj, Veseli

dojë edhe për dialogun me Serbinë

dhe Limaj, se që këta protagonistë dhe subjektet politike të rreshtuara pas tyre, janë të motivuar për gjetjen e formulës së bashkëpunimit që buron nga interesi kombëtar", është shprehur Maliqi.

Njohësi i rrethanave politike në vend nuk beson se zgjedhjet e reja tani do të mund të ishin zgjidhja më e mirë. Sipas Maliqit, zgjedhjet janë gjithnjë të mirëseardhura nëse ato çojnë drejt daljes nga kriza dhe premtojnë rezultatin më deciziv në favor të partive në pushtet ose të atyre në opozitë. "Po anketat tregojnë se nuk ka lëvizje të mëdha të disponimit të elektoratit dhe se edhe pas zgjedhjeve të reja të parakohshme do ta kemi skenën pothuajse të njëjtë të përçarë në dy blloqe. Jam skeptik se ato mund të nxjerrin rezultatin me koalicionet e reja 'shpëtimtare'. Nga ana tjetër, është reale frika se do të na rrëshqasë prej duarsh mundësia që ta finalizojmë dialogun me një marrëveshje historike që shton shtetësinë e Kosovës", ka thënë Maliqi.

"Epoka e re": Z. Maliqi, kjo legjislaturë arriti që me votat e pozitës dhe të opozitës ta miratojë pakon e projektligjeve për transformimin e FSK-së në ushtri. Mirëpo për çështje të tjera LDK-ja dhe LV-ja po i braktisin seancat e Kuvendit. Cili është vlerësimi juaj për situatën politike në vend?

Maliqi: Është shenjë e mirë që për një çështje madhore çfarë është zhbllokimi i krijimit të ushtrisë së Kosovës është arritur uniteti pothuajse absolut ndër deputetët shqiptarë dhe të pakicave, pos atyre serbë. Por ky lloj i unitetit dhe i përkushtimit do të duhej të ekzistonte edhe për çështjet e tjera që i përmendet, e që janë të po kësaj rëndësie për qëllimin e rrumbullakimit të shtetndërtimit të Kosovës.

Bojkoti nuk është mjet që ndihmon në zgjidhjen e çështjeve madhore, sepse bëhet fjalë për çështje që kërkojnë koncentrim të votës, e jo thellim të përçarjes dhe bllokadës së proceseve që, pa dyshim, i shpërfaq bojkoti. Pastaj, nëse shihet se cilat janë qëndrimet e pozitës dhe të opozitës rreth vijave të kuqe që nuk mund të kapërcehen në dialogun me Serbinë dhe marrëveshjen finale, është e qartë se në vijat e trasha mes tyre ekziston pajtimi. Vetëm LV-ja sikur ka kushtëzime rreth dialogut që e kthen atë në fillim dhe nuk e shtyn drejt finalizimit. Po kështu, ekziston edhe bindja dhe pajtimi se çdo marrëveshje që arrihet në dialog duhet të aprovohet dhe ratifikohet nga Kuvendi, çka nënkupton se edhe mund të refuzohet nëse nuk e mbështes shumica. Nëse instanca sovranë e vendosjes mbetet te Kuvendi atëherë nuk e shoh ku është problemi me procesin, pos nëse ai nuk kuptohet si një diktaturë e atyre që mbesin në pakicë.

"Epoka e re": Pavarësisht PREJ përpjekjeve të shumta, pozita dhe opozita nuk po mund ta gjejnë një gjuhë të përbashkët për dialogun me Serbinë. Projektrezoluta e PSD-së për dialogun Kosovë - Serbi nuk është votuar në Kuvend, sikurse nuk është votuar as ajo e LDK-së dhe as ekipi negociator i Qeverisë për dialogun me Serbinë. Si duhet të veprohet për arritjen e një konsensusi kombëtar për këtë çështje?

Maliqi: Mendoj se LV-ja dhe LDK-ja janë duke e stërmadhuar problemin e përfaqësimit dhe udhëheqjes të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, si një levë politike që e mënjanon presidentin Hashim Thaçi nga ky proces, por edhe të defaktorizimit të tij të plotë politik. LDK-ja të paktën nuk do të duhej të luante

këtë lojë prej hipokriti hakmarrës, sepse Thaçi është bërë president falë votës së LDK-së. Nga ana tjetër, po të isha unë në vendin e presidentit, do të bëja çmos ta arrij kompromisin me opozitën me të cilin do të krijohej hapësirë për një rol dhe përgjegjësi të plotë të opozitës në procesin e dialogut, e që nuk do të dëmtonte as të drejtën kushtetuese dhe ambicien e presidentit që të mbetet pjesë e rëndësishme e dialogut dhe vendimmarrjes. Ndërkaq, opozita sikur qëllimin e ka në përjashtimin e presidentit. Fatkeqësisht, e gjithë beteja rreth dialogut tani është personalizuar për së tepërmi sepse më shumë dalin në sipërfaqe smirat dhe inatet e ndërsjella të treshes Thaçi, Mustafa dhe Kurti, por edhe treshes tjetër Haradinaj, Veseli dhe Limaj, se që këta protagonistë dhe subjektet politike të rreshtuara pas tyre, janë të motivuar për gjetjen e formulës së bashkëpunimit që buron nga interesi kombëtar.

"Epoka e re": Nëse nuk arrihet një konsensus i tillë, besoni se këtë proces do të mund ta shtyjë përpara vetëm Qeveria me presidentin Thaçi?

Maliqi: Presidenca me Qeverinë e kanë udhëhequr edhe deri më tash dialogun, rezultatet e të cilit janë edhe meritë e LDK-së kur ka qenë pjesë e Qeverisë dhe dialogut. Nëse Qeveria aktuale mbetet në pushtet kështu si është zhargas, sepse nuk po mund ta mbledhë shumicën për mocionin e mosbesimit dhe të rrëzimit të Qeverisë, atëherë ka gjasa që dialogu ta vazhdojë formulën e kompromisit që është arritur te mazhoranca që presidenti Thaçi të dialogojë me presidentin e Serbisë, kurse Fatmir Limaj të jetë koka e dytë e dialogut, edhe pse nuk është bërë e qartë si do të funksionojë ky dualizëm i përfaqësimit. Dhe me që po rrjedh

koha që faktorët ndërkombëtarë e kanë parashtruar jo pa arsye, që marrëveshja e mundshme të arrihet deri në pranverë të vitit 2019, nuk po shoh ndonjë alternativë më unifikuese të përfaqësimit. Kjo garniturë Presidencë-Qeveri mund ta propozojë marrëveshjen, por në aktin final duhet të llogaritet edhe participimi i opozitës.

"Epoka e re": Opozita vazhdimisht po e kërcënon Qeverinë me mocion mosbesimi. Në këto rrethana, cilat janë mundësitë e opozitës me këta numra të rrëzohet këtë Qeveri?

Maliqi: Nëse do të mund t'i mbledhte votat e duhura, opozita tashmë do ta kishte rrëzuar Qeverinë. Por, nuk i ka votat dhe nuk jam i sigurt se do të mund t'i sigurojë.

"Epoka e re": A janë zgjedhjet zgjidhje në këtë situatë?

Maliqi: Zgjedhjet janë gjithnjë të mirëseardhura nëse ato çojnë drejt daljes nga kriza dhe premtojnë rezultatin më deciziv në favor të partive në pushtet ose të atyre në opozitë. Po anketat tregojnë se nuk ka lëvizje të mëdha në disponimin e elektoratit dhe se edhe pas zgjedhjeve të reja të parakohshme do ta kemi skenën pothuajse të njëjtë të përçarë në dy blloqe. Jam skeptik se ato mund të nxjerrin rezultatin me koalicionet e reja "shpëtimtare". Nga ana tjetër, është reale frika se do të na rrëshqasë prej duarsh mundësia që ta finalizojmë dialogun me një marrëveshje historike që shton shtetësinë e Kosovës. Për bllokadë gjithnjë do të ketë mundësi nëse marrëveshja, siç thonë skeptikët, do të jetë e disfavourshme. Por çka nëse tani humbin kohë dhe rrethanat ndërkombëtare në ndërkohë e vështirësojnë pozitën e Kosovës dhe atë marrëveshje të synuar që ia siguron Kosovës anëtarësimin në OKB?

Kastrati: FSK-së i duhen edhe shtatë vjet për t'u bërë ushtri

PRISHTINË, 21 TETOR - Ish-komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, ka thënë se kalimi në Kuvend i tri projektligjeve është lajmi më i mirë për Kosovën që nga shpallja e pavarësisë. Kastrati ka bërë me dije se FSK-së i duhen shtatë vjet për t'u bërë ushtri. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Kastrati ka theksuar se ushtria e Kosovës nuk do të pajiset me armatim të rëndë, mirëpo do të jetë në gjendje t'i kryejë detyrat e veta me të cilat obligohet me ligj. "Gjatë viteve 2012-2014, kur

është bërë rishikimi strategjik i sektorit të sigurisë, është bërë edhe plani i ngritjes së kësaj force, apo plani i veprimit që është paraparë në atë kohë 10 vjet, por unë rekomandoj fuqishëm institucionet e Kosovës, pasi ne jemi vonuar katër vjet, që ky plan të zvogëlohet në shtatë vjet. Ko është paraparë me faza. Faza e parë është ngritja apo shndërrimi i Ministrisë së Forcës së Sigurisë në Ministri të Mbrojtjes, riorganizimi i saj. Pastaj është ngritja e doktrinave, rregulloreve, e gjithë ai

dokumentacion që duhet të adoptohet bazuar në ligjet që tashmë kanë kaluar në Parlament dhe ristrukturimi i strukturës të ushtrisë që do të jetë më ndryshe. Një vit ose një vit e gjysmë, kjo forcë do të punojë vetëm në ristrukturim dhe në përpilim të këtyre dokumenteve, pastaj do të shkohet çdo vit me blerjen e armatimeve, pajisjeve shtesë dhe për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, duhet të jenë edhe 2 500 pjesëtarë të rinj dhe 3 000 rezervë sa janë paraparë në forcën ushtarake", ka thënë Kastrati.



Në fshatin Gllarevë zbulohet lapidari i dëshmorit të kombit, Haki Morina



EPOKA E RE Qendresa RAMA

KLINË, 21 TETOR - Më 20 tetor (e shtunë) në fshatin Gllarevë të Klinës është bërë zbulimi i lapidarit të dëshmorit të kombit, Haki Morina. Zbulimi i këtij lapidari është bërë me rastin e 27-vjetorit të rënies së tij në Osojnik afër Dubrovnikut në Kroaci, ku luftoi kundër pushtuesit serb. Ndërkaq në përkujdesje të kryetarit të Komunës së Klinës, Zenun Elezaj dhe organizimit të shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Klinë, është mbajtur akademi përkujtimore kushtuar dëshmorit të kombit, Haki Dinë Morina.

Akademia është mbajtur në fshatin Gllarevë, ku me një fjalë rasti kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka thënë se Haki Dinë Morina ishte shembull për të gjithë ata që besuan në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe lirinë e këtij vendi. "Po ashtu, sot, në këtë vend, jemi tubuar për ta rilindur në

lapidar këtë dëshmor të atdheut tonë të shtrenjtë, i cili do të rrezatojë dritë përjetësie dhe dritë ardhmërie për brezat që vijnë. Lufta për lirinë e këtij vendi është e hershme sa edhe përpjekjet e këtij populli për lirinë e atdheut. Tempulli i lirisë së Kosovës ka qenë i gjerë për t'u mbushur me gjakun e bijave dhe bijve më të shtrenjtë të këtij kombi. Tempulli i lirisë ka qenë vendi ku janë bashkuar emrat e më të shtrenjtëve të Kosovës, ata u dolën zot vatrave tona, kësaj toke që e kanë trashëguar nga të parët tanë. Prandaj, këtij ideali shumë herët i është bashkuar edhe dëshmorit i kombit, biri i këtij vendi, Haki Dinë Morina, duke bërë veprën më sublime, në moshën më të re atdheut të tij duke ia falë jetën", ka thënë Elezaj.

Ai ka shtuar se ky lapidar që po lartësohet sot në Gllarevë dëshmon çmimin e lirisë së Kosovës. "Ky lapidar është simbol që i jep dinjitet për jetën e ndërprerë në fillim të tyre. Një tokë që mban mbi vete këtë lapidar, dhe të shumë ide-

alistëve të tjerë, që jetën e tyre e dhanë për idealin e lirisë së Kosovës, e ka të sigurt një të ardhme të ndritshme", ka thënë kryetari Elezaj.

Ai ka shtuar se Hakiu dhe gjithë bashkëveprimtarët dhe bashkëveprimtarët e tij tërësisht ishin të vetëdijshëm se një ditë gjaku dhe sakrifica do të kulmojnë me lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, aspiratën e tij dhe të gjithë dëshmorëve të lirisë së këtij vendi. "Pra, nga rrënjët e gjakut të këtij dëshmorit të kombit dhe gjithë dëshmorëve dhe martirëve të tjerë, u lind shteti i Kosovës, të cilin sot



po e ndërtojmë dhe po e forcojmë në përpjekje që të gjejë një vend nën kulmin e shteteve demokratike, po ashtu edhe strukturat e tjera të Aleancës Veri-atlantike", ka deklaruar kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj. Veprimtari Ismet Sylejmani ka thënë se Hakiu bashkë me vëllezërit e vet ka qenë pjesë aktive e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës e cila në vitin 1994 bëhet themeluesja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Populli shqiptar luftës për liri e çlirim ia ka dhënë bijat dhe bijtë më të mirë, por edhe lufta ia ka marrë më të mirët, më luftarakët, ata të çeliktët e i tillë, ndonëse i ri në moshë, thonë se ishte edhe dëshmorit Haki Morina, të cilit po i përulemi dhe i bëjmë nderime sot", ka thënë Sylejmani.

Ai ka shtuar se rënia e Hakiut është heroike, sepse ka rënë duke luftuar i vetëm kundër një ushtrie të tërë në Osojnik afër Dubrovnikut në Kroaci! "E ka gjetur vdekja të rrethuar nga ushtarë e paramilitarë serbë, periudhë kjo kur artileria serbe granatonte e bombardonte qytetin e lashtë të Dubrovnikut! Prandaj shpallja dëshmorit i kombit është nderim dhe respekt, mirën-

johje e përulje, pasi edhe larg Kosovës, në Kroacinë aleate të popullit shqiptar, luftoi kundër të njëjtit pushtues - Serbisë", ka thënë Sylejmani.

Vëllai i dëshmorit Haki Morina, Gani Morina, ka falënderuar të gjithë ata që gjeten kohë të marrin pjesë në zbulimin e lapidarit të vëllyait të tyre. "Po ashtu, më lejoni t'i falënderoj qytetarët e Gllarevës, Klinës me rrethinë dhe gjithë Kosovës, si dhe gjithë aktivistët e asaj kohe, pa dallim, për organizimin e pashembullt shtetëror të ceremonisë së varrimit të dëshmorit Haki Morina, tash e 27 vjet më parë, meqë nuk kemi pasur rastin t'i falënderojmë kështu publikisht", ka thënë Gani Morina. Ai ka falënderuar të gjithë ata djem dhe vajza që për vite të tëra, në rrethana të rënda të okupimit, mbajtën gjallë Shoqërinë Kulturore-Artistike, që u themelua më 1993, e që mban emrin Haki Morina. "Më lejoni që ta falënderoj Kuvendin Komunal të Klinës, që në vitin 2015 dha lejen për ngritjen e këtij lapidari, këtu në pronën e komunës. Po ashtu, Kuvendin Komunal të Klinës në shenjë nderimi dhe respekti për veprën e dëshmorit ka emërtuar rrugën që shtrihet nga magjistratja Prishtinë-Pejë në drejtim të lagjes ku u lind dhe u rrit Haki Morina. Falënderojmë të gjithë ata që ofruan ndihmë, sado simbolike, për ngritjen e lapidarit, emrat e të cilëve do të zënë vend në një libër që do të botohet për veprën e Hakiut, si dhe një dokumentar i cili së shpejti do të realizohet, e ku do të flasin dëshmitarë okularë e ku do të zbardhen shumë gjëra të pathëna", ka thënë Gani Morina.

Shqiptarët çdo ditë e më shumë po zgjohen dhe konsolidohen

Gani MORINA

Të nderuar pjesëmarrës të kësaj ceremonie përkujtimore, më lejoni që në emër të familjes Morina t'ju shpreh falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për praninë tuaj sot, duke na nderuar ne, para së gjithash veprën e birit, vëllait e xhaxhait tonë, Haki Morina.

Po ashtu, më lejoni t'i falënderoj qytetarët e Gllarevës, Klinës me rrethinë dhe gjithë Kosovës, si dhe gjithë aktivistët e asaj kohe, pa dallim, për organizimin e pashembullt shtetëror të ceremonisë së varrimit të dëshmorit, Haki Morina, tash e 27 vjet më parë, meqë nuk kemi pasur rastin t'i falënderojmë kështu publikisht.

Faleminderit gjithë atyre vajzave dhe djemve që për vite të tëra, në rrethana të rënda të okupimit, mbajtën gjallë Shoqërinë Kulturore-Artistike që u themelua



më 1993, e që mbante emrin Haki Morina.

Aktivistët dhe aktivitetet e kësaj shoqërie shfaqnin mllëfin kundër pushtuesit dhe gjithmonë ishin një kushttrim lufte.

Për këtë lapidar, kryesia e fshatit Gllarevë kishte marrë iniciativë për ta ngritur qysh në vitin 1993,

por këtë nuk e pati pranuar vëllai ynë, Lutfiu. Ai në një mbledhje të fshatit tha: "Nuk është koha për lapidare, edhe po ta pyesnim Hakiun, ai do të na thoshte: Me ato para blini armë".

Kjo pasoi me një heshtje, që ishte pohuese.

Më lejoni që ta falënderoj

Kuvendin Komunal të Klinës, që në vitin 2015 dha lejen për ngritjen e këtij lapidari, këtu në pronën e komunës.

Po ashtu, Kuvendin Komunal të Klinës në shenjë nderimi e respekti për veprën e dëshmorit që ka emërtuar rrugën që shtrihet nga magjistratja Prishtinë - Pejë në drejtim të lagjes ku u lind dhe u rrit Haki Morina.

Falënderojmë të gjithë ata që ofruan ndihmë, sado simbolike, për ngritjen e lapidarit, emrat e të cilëve do të zënë vend në një libër që do të botohet për veprën e Hakiut, si dhe një dokumentar i cili së shpejti do të realizohet, e ku do të flasin dëshmitarë okularë e ku do të zbardhen shumë gjëra të pathëna.

Ata që bënë e përpiluan dosje dje, kundër djemve më të mirë të Kosovës, po vazhdojnë edhe sot me kurthe e shantazhe kundër djemve të lirisë, duke vepruar si dorë e fshehtë, mbase edhe të infiltruar ndonjëherë edhe në

poste institucionesh.

Por, ata duhet ta dinë se tentakulat e tyre, ato lozë pocerrke, ne e dimë ku i kanë rrënjët. Janë të kota akrobacionet e tyre.

Shqiptarët sot në Ballkan kanë dy shtete të pavarura, të cilat ditaditës po konsolidohen, derisa Maqedoninë e kemi përgjysmë, e në dorën tonë është çelësi i ekzistencës së saj. Shqiptarët edhe përreth trunqut të shteteve të tyre të pavarura çdo ditë e më shumë po zgjohen e konsolidohen.

Këto fitore e ato që do të pasojnë janë rezultat i gjakut të derdhur për liri ndër breza, si dhe mbështetjes së miqve tanë.

Lavdi dëshmorëve të kombit!
Lavdi dëshmorit Haki Morina!
Faleminderit!

(Autori është vëllai i dëshmorit Haki Morina. Ky fjalim është mbajtur më 20 tetor të këtij viti, me rastin e 27-vjetorit të rënies së dëshmorit Haki Morina dhe zbulimit të lapidarit të tij)

LDK-ja kërkon mobilizim të strukturave për zgjedhje të reja

Sekretari i përgjithshëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Ismet Beqiri, ka bërë me dije të dielën se shumë shpejt vendi mund të shkojë në zgjedhje të reja. Ai në takim me strukturat e Degës së V të LDK-së në Prishtinë ka theksuar se kjo parti, duke e parë bllokimin e vendit nga kjo qeveri dhe brishtësinë e koalicionit qeverisës, mendon se zgjidhja e vetme janë zgjedhjet

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 TETOR - Anëtarët e Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) të dielën janë pritur në takim nga strukturat e Degës së V në Prishtinë. Me këtë rast sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Ismet Beqiri, ka thënë se kjo formë e takimit me struktura po shërben që të njoftohen forumet e partisë me qëndrimet e fundit të LDK-së për dialogun, kufijtë e Kosovës dhe për votimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Beqiri ka kërkuar që të gjithë të organizohen sepse, sipas tij, bazuar në mundësitë që LDK-ja po i kërkon në koordinim edhe me partitë e tjera për ngritjen e

mocionit të votëbesimit të Qeverisë, vendi shumë shpejt do të shkojë në zgjedhje të reja. Ai ka thënë se LDK-ja, duke e parë bllokimin e vendit nga kjo Qeveri dhe brishtësinë e koalicionit qeverisës, mendon se zgjidhja e vetme janë zgjedhjet. Beqiri ka kërkuar mobilizimin e të gjitha strukturave të degës për t'u përgatitur për zgjedhjet qendrore të cilat, sipas tij, janë të pashmangshme.

Ndërsa anëtari i Kryesisë së LDK-së, Sokol Haliti, ka folur për mbledhjet e vazhdueshme të kryesisë së kësaj partie, për unitetin dhe disponimin e mirë brenda të gjitha strukturave dhe organeve të partisë. Ai ka kërkuar nga të gjithë aktivistët që të angazhohen që LDK-ja të forcohet sidomos në Prishtinë

sepse, sipas Halitit, baza e fitores së LDK-së në nivel vendi është Prishtina.

Edhe anëtari i Kryesisë, Muharrem Sfarqa, ka thënë se duhet mobilizim në mënyrë që LDK-ja të jetë gati për zgjedhjet, të cilat, sipas tij, janë të pashmangshme pasi që Qeveria

është shndërruar në mekanizëm për plotësimin e tekeve të individëve dhe grupeve të interesave biznesore.

Edhe anëtarja e Kryesisë së LDK-së, Vlora Dumoshi, ka theksuar se ky bashkëbisedim duhet të shërbejë për një organizim më të mirë që LDK-ja të

konfirmohet në çdo proces si parti e fortë dhe e pathyeshme ndaj konkurrentëve tjerë politikë. Kurse kryetarja e Forumit të Gruas së LDK-së, Lirije Kajtazi, ka folur për mundësitë e trajnimeve për gratë e forumit me ndihmën e Fondacionin KAS.

'Lojë pingpongu' e Prokurorisë dhe Gjykatës me rastin e veteranëve të UÇK-së

Prishtinë, 21 tetor - Prokuroria është duke punuar për plotësimin e aktakuzave për lëndën e njohur si rasti i "veteranëve të rrejshëm", e cila i është kthyer Prokurorisë Speciale për plotësim dhe qartësim.

Prokurori Sylë Hoxha, i ngarkuar për komunikim me mediet nga Prokuroria Speciale e Kosovës, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se aktualisht po punohet për eliminimin e mangësive që gjykata i ka vlerësuar të paplotësuar në aktakuzë. "Pas plotësimit të vërejtjeve apo mangësive që janë dhënë, aktakuza do të dorëzohet në rrugë normale në procedurë, si çdo aktakuzë tjetër apo siç ishte dërguar më parë", ka thënë Hoxha. Instituti i Kosovës për Drejtësi ka vlerësuar se ky rast nga sistemi i drejtësisë po prolongohet qëllimisht.

Në këtë Institut që monitoron punën e prokurorive dhe gjykatave, thonë se këtij rasti Prokuroria nuk është duke ia kushtuar vëmendjen e duhur.

Ehat Mifaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se është për keqardhje se si Prokuroria Speciale po e trajton

këtë rast. "Faktikisht, çka është duke ndodhur me këtë aktakuzë është ajo çka ne, si publik, i jemi frikësuar, që për rastet e nivelit të tillë, të fillojë të luhet loja e pingpongut, do të thotë të kthehet sa në Gjykatë e Prokurori, e të kalojnë afate kohore dhe të silltet nëpër korridorët e Gjykatës dhe Prokurorisë", ka thënë Mifaraj. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kishte ngritur aktakuzë të cilën e ka dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër 12 të pandehurve, për lëndën e njohur në opinion si 'veteranët', në drejtim të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Por, më vonë, Gjykata Themelore në Prishtinë, këtë aktakuzë e ka kthyer sërish në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për plotësim dhe qartësim.

Mifaraj ka thënë se është pakuptim se si një Prokurori Speciale ngre një aktakuzë dhe e njëjta është e pakompletuar dhe kthehet prapë në Prokurori. "Ne kemi kritikuar qasjen e prokurorit të shtetit ku në një aktakuzë të tillë ka pësuar ndryshime duke kërkuar që në rastin e veteranëve



të rrejshëm të paraqitet kërkesa për masë të përkohshme, si dhe në kuadër të njëjtës aktakuzë të futen emrat e mbiemrat, të dhënat personale të mbi 20 mijë personave. Një taktikë dhe një qasje e tillë e Prokurorisë automatikisht ka dërguar mesazhe të publiku se qëllimi është më shumë që kjo lëndë të prolongohet sesa e njëjta të trajtohet në gjykatë", ka deklaruar Mifaraj.

Organizata e Veteranëve të Luftës së ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kërkon nga institucionet e Kosovës që çështja e statusit të veteranëve ta kthehet në pikën zero. Drejtuesit e kësaj organizate thonë se kjo duhet të bëhet në mënyrë që të sqarohet gjithçka dhe të hiqen dyshimet për veteranët "mashtrues". Sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdon të mbetet i ekspozuar

ndaj ndikimit politik dhe ky ndikim është në formë të ndryshme, vlerësojnë zyrtarë të institucioneve të larta të Kosovës, si dhe njohës të çështjeve juridike në vend.

Rasti, i cili muajt e fundit ka ngjallur debat dhe polemika jo vetëm në opinion, por edhe ndërmjet drejtuesve institucionalë, është rasti i "Listës së veteranëve".

Dhjetë kompani nga Kosova marrin pjesë në panairin SIAL 2018

Në kuadër të politikave mbështetëse për prodhuesit vendorë dhe bizneset, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), përkatësisht KIESA, ka mbështetur praninë e kompanive të Kosovës në panairin më të madh botëror SIAL 2018 që po mbahet në Paris. Sivjet Kosova në këtë panair prestigjioz përfaqësohet me dhjetë kompani të prodhuesve më të mëdhenj ushqimorë: "Frutomania", "ABI", "Devolli Co.", "Ujë Rugova", "Eurofood", "Agrium", "Bodrumi i Vjetër", "Elkos (Pi&Ki)" dhe "Frutex"



ekspozojnë produktet e tyre. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht KIESA, ka mbështetur praninë e kompanive kosovare në këtë panair financiarisht, ndërsa pronarët dhe përfaqësuesit e këtyre kompanive u shprehën të kënaqur që Qeveria e Kosovës, në këtë rast MT-ja, ka bërë të mundur paraqitjen e kompanive të tyre në SIAL me të cilin rast janë hapur dyert e bashkëpunimit me kompani të tjera nga e gjithë bota.

Zëvendëskryeministri Dardan Gashi, në emër të Qeverisë së Kosovës, u shpreh jashtëzakonisht i kënaqur me praninë e kompanive dhe premtori mbështetje të vazhdueshme

dhe më të madhe në panairin e tjerë. "Ne kemi një produkt shumë kualitativ i cili e meriton që të eksportohet sa më shumë. Qeveria e Kosovës do të jetë pranë prodhuesve vendorë tani dhe në të ardhmen, me shpresë që në katër ditët në vijim, sa zgjat ky panair, kompanitë tona të nënshkruajnë sa më tepër kontrata me kompani të huaja për eksport. Puna dhe mbështetja jonë nga ana tjetër nuk do të ndalet me kaq", është shprehur Gashi. Ai ka vizituar edhe një kompani prodhuese nga Shqipëria, e cila e vetmuar kishte ekspozuar prodhimet, pasi qeveria shqiptare nuk është përfaqësuar në nivel shteti dhe nuk ka dhënë

mbështetje për prodhuesit vendorë.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se në kuadër të politikave mbështetëse për prodhuesit vendorë dhe bizneset, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht KIESA, ka mbështetur praninë e kompanive të Kosovës në panairin më të madh botëror SIAL 2018. "Këtë mbështetje po ua bëjmë bizneseve që ato të rrisin sa më shumë cilësinë, standardin dhe rritjen e eksportit të kompanive vendore prodhuese. MTI-ja do t'i mbështesë bizneset vazhdimisht me politika konkrete, që t'i bëjë konkurrense në tregun e Bashkimit Evropian", ka thënë Shala.

Ndërsa kompanitë e Kosovës që kanë ekspozuar produktet dhe veprimtarinë e tyre në këtë panair u shprehën mirënjohëse për Qeverinë që financiarisht ka ndihmuar duke paguar për tërë hapësirën që shfrytëzohet nga ta në SIAL.

Përfaqësuesi nga kompania "Frutex" u shpreh i kënaqur me ndihmën e ofruar për t'u përfaqësuar në këtë panair prestigjioz. "Është mundësi e mirë për ne që të jemi të pranishëm këtu pasi që përmes kontakteve dhe takimeve kemi mundësi edhe të nënshkruajmë marrëveshje të ndryshme eksporti", thanë ata.

Edhe kompanitë e tjera pa përjashtim u shprehën falënderuese për MTI-në dhe tërë Qeverinë e Kosovës për mbështetjen e ofruar. Sivjet Kosova në këtë panair prestigjioz përfaqësohet me dhjetë kompani të prodhuesve më të mëdhenj ushqimorë: "Frutomania", "ABI", "Devolli Co.", "Ujë Rugova", "Eurofood", "Agrium", "Bodrumi i Vjetër", "Elkos (Pi&Ki)" dhe "Frutex".

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 TETOR - Republika e Kosovës është duke u përfaqësuar me dhjetë kompani në

panairin më të madh botëror SIAL 2018 që po mbahet në Paris. SIAL 2018 është panairi më i madh i ushqimit dhe pijeve në botë, ku rreth 7 200 biznese nga 120 shtete të botës



Qeveria kërkon përfundimin e procesit të privatizimit

PRISHTINË, 21 TETOR - Qeveria e Kosovës është e interesuar që në një kohë më të shpejtë ta përmbyllë procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, proces ky i filluar qysh në vitin 2003. Zyrtarë të Qeverisë thonë se ky proces është zgjidhur së tepërmi. Nga rreth 600 ndërmarrje shoqërore sa figurojnë të jenë në pronësi të Republikës së Kosovës, sipas të dhënave të prezantuara kohë më parë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, janë privatizuar shumica prej tyre, prej të cilave janë krijuar nga një apo dy ndërmarrje të reja private.

Sipas Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të paprivatizuara kanë mbetur rreth 2 000 asete të ndërmarrjeve shoqërore. Në mesin e aseteve të paprivatizuara numrin më të madh e përbëjnë tokat bujqësore.

Këshilltari për ekonomi në Qeverinë e Kosovës, Haki Shatri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Qeveria është e interesuar ta shtojë procesin e privatizimit dhe ta përmbyllë sa më shpejt pa i lënduar rregullat e punës. "Jemi të angazhuar ta mbyllim procesin pasi që po tejzgjatet edhe jashtë nevojës, por që nuk kemi asgjë konkrete deri më tani, pasi kemi qenë shumë të angazhuar në proceset e mëdha si liberalizimi i vizave, transformimi i Forcës së Sigurisë

së Kosovës, anëtarësimi në Interpol dhe procese të tjera që na kanë bllokuar që të mos merremi me këtë çështje. Por pasi që t'i përmbyllim të gjitha këto procese deri në fund të vitit, pastaj tërë potencialin do të zhvendosim në çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, ku hynë edhe procesi i privatizimit dhe përmbyllja e tij", ka thënë Shatri. Pavarësisht prej periudhës kohore kur mund të përfundojë procesi i privatizimit, ky proces në Kosovë, nga ekspertë të ndryshëm për çështje ekonomike, është konsideruar i pasuksesshëm, duke mos përbushur objektivat dhe pritjet e veta ekonomike.

Eksperti i çështjeve ekonomike, Ismail Kastrati, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se procesi i privatizimit nuk ka dhënë efektet e pritura, zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe as rezultate në punësim. "Procesi i privatizimit në përgjithësi është një proces me rezultate të dobëta për mos të thënë i dështuar. Zgjatja e procesit të privatizimit duhet ta ketë një fund, por problemi qëndron në atë se çështjet nuk janë të qarta, në veçanti mjetet e fondit të privatizimit ku nuk është zgjidhur se çfarë do të bëhet me ato mjete dhe, si duket, burokracisë i konvenojnë proceset të zgjasin sa më shumë në



mënyrë që të këtë përfitime për grupe të caktuara", ka deklaruar Kastrati.

Për një proces jo të mirë të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, shprehet edhe Haki Shatri, këshilltar për ekonomi në Qeverinë e Kosovës. "Kemi vlerësime se si proces privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore nuk është mjaft i kënaqshëm, nuk janë rezultatet e

pritura si në fillim. Si proces ka pasur përkrahje nga të gjithë, si duket vitet e fundit është pasivizuar dhe nuk jemi të kënaqur", ka theksuar Shatri.

Nga shitja e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore thuhet të jenë rreth 700 milionë euro të grumbulluara, prej të cilave 110 milionë euro janë ndarë në emër të 20-përqindëshit që ndahen për punëtorët pas shitjes së ndër-

marrjes, në të cilën kanë punuar, kurse për kreditorët potencialë janë paguar rreth 20 milionë euro.

Nga fondi tepriçë në buxhetin e Kosovës AKP-ja ka derdhur mbi 100 milionë euro. Ndërkaq, në Fondin Rezervë janë më shumë se 460 milionë euro që, sipas përfaqësuesve të AKP-së, mbahen në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në BQK thonë se ekonomia po shënon përmirësim, do të rritet në 4.4 për qind

PRISHTINË, 21 TETOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka njoftuar se, sipas projeksioneve të veta, prospektet për rritje ekonomike të Kosovës në vitin 2018 janë pozitive, me ç'rast ekonomia pritet të shënojë një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2017, duke u luhatur në një interval prej 4.2 përqindësh në 4.4 për qind. "Ky përmirësim i atribuohet stimulit të përforuar fiskal gjatë vitit 2018, veçanërisht atij të gjeneruar nga shpenzimet kapitale të Qeverisë", thuhet në raportin e Stabilitetit Financiar të BQK-së.

Sipas BQK-së, remitencat dhe aktiviteti kredihënës, edhe gjatë vitit 2018, pritet të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik dhe se ambienti i jashtëm pritet të jetë favorizues për bilancin tregtar, bazuar në rishikimin për lart të aktivitetit ekonomik në vendet partnere tregtare të Kosovës. "Performanca financiare e sek-

torit të ndërmarrjeve është përmirësuar, duke u reflektuar në përmirësim të cilësisë së kredisë nga ky sektor. Performanca më e mirë financiare ka ndikuar, në njërin anë, në rritjen e kërkesës për kredi, në anën tjetër përmirësimi i vazhdueshëm i faktorëve strukturorë dhe kushteve për qasje në financa, kanë mundësuar rritjen e ofertës për kredi ndaj sektorit të ndërmarrjeve. Kredia e re për ndërmarrjet nga sektori bankar është rritur për 35 për qind, që shënon rritjen më të lartë në shtatë vjetët e fundit. Ndërmarrjet kanë vazhduar rritjen e financimit nga burimet e jashtme, me ç'rast borxhi i jashtëm arriti pjesëmarrjen në 21.1 për qind të gjithsejtë borxhit të ndërmarrjeve", thuhet në raportin e Stabilitetit Financiar të BQK-së. Sipas BQK-së, rritja e gjithsejtë borxhit të ndërmarrjeve ka kontribuar në thellimin e borxhit të ndërmarrjeve në 32.9 për qind ndaj BPV-së dhe



përafrimin drejt vendeve të rajonit. "Ndërmarrjet nuk kanë ekspozim direkt ndaj ndryshimeve në kursin valutor

si rezultat i pozicionit tejet të ulët në valutë të huaj. Sidoqoftë, ndryshimet në valutë mund të ndikojnë në

aktivitetin afarist, sidomos të ndërmarrjeve tregtare", thuhet më tutje në raportin e Stabilitetit Financiar të BQK-së.

Nis ndërtimi i sheshit kryesor në Kastriot

KASTRIOT, 21 TETOR (ER)

Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, ka pritur në takim kryeministrin Ramush Haradinaj dhe ministrin e Infrastrukturës (MI), Pal Lekaj, të cilët i ka njoftuar për projektet që janë duke u realizuar në këtë komunë. Pas këtij takimi, Gashi, Haradinaj dhe Lekaj kanë përfunduar fillimin e punimeve për realizimin e projektit për ndërtimin e sheshit të qytetit, projekt ky i bashkëfinancuar nga MI-ja dhe Komuna e Kastriotit. "Kastrioti (Obiliqi) po ndryshon. Sot në Kastriot janë 43 projekte në realizim. Sot është projekti i 44-të, ndërsa të hënën do ta fillojmë realizimin e projektit të 45-të", ka thënë kryetari Gashi, duke potencuar se të gjitha këto projekte po bëhen me përkrahjen e Qeverisë Haradinaj. Më tutje, Gashi ka folur edhe për Ligjin për Kastriotin, duke thënë se ky ligj do të krijojë mundësi për ndryshimin e



gjendjes faktike të kësaj komune jo vetëm në aspektin e ndërtimeve të vjetra, por edhe atë shëndetësor. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se qytetarët e Kastriotit meritojnë më shumë investime. "Është një moment gëzimi sepse po ndodh një punë e qëlluar dhe e drejtë në vendin që i takon, te njerëzit që vërtet e meritojnë. Jemi në proces të investimeve në energji alternative, por edhe në teknologji të re me qymyr dhe po punojmë intensivisht që vetvetiu të mos hetohet ndotja, por të jetë Kastrioti një vend i pëlqyer nga të gjithë", ka thënë Haradinaj. Sheshi kryesor në Kastriot do ta mbajë emrin e kontribuuesit të madh të kësaj komune, Adem Preniqi.



Kryetari i Deçanit nderon dëshmorët e kombit

DEÇAN, 21 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë homazhe te varri i ish-eporit të UÇK-së, Skënder Rexhahmetaj, në fshatin Isniq të kësaj komune.

Po ashtu, Ramosaj ka nderuar veprën e dy vëllezërve heronj nga Pobergja. "Homazhe në nderim të eprorit të UÇK-së dhe bashkëpunëtorit tonë Skënder Rexhahmetaj në Isniq. Në

Pobergjë nderuam jetën dhe veprën e vëllezërve dëshmorë - heronjve Arif dhe Agim Pangjaj-Vokshi. Përjetësisht lavdi!", ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook".



I vihet gurëthemeli Qendrës së Banimit Social në Malishevë

MALISHEVË, 21 TETOR (ER) - Në Komunën e Malishevës është vënë gurthemeli i Qendrës së Banimit Social, duke shënuar kështu edhe zyrtarisht fillimin e ndërtimit të kësaj qendre. Ndërtimi i kësaj qendre është një prej projekteve më të mëdha që realizohet gjatë këtij viti në Malishevë dhe është projekt i cili ka rëndësi të madhe për sigurimin e strehimit për dyzet familje në nevojë. Në ceremoninë e fillimit të punimeve morën pjesë zëvendëskryeministri

Fatmir Limaj, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, zëvendëskryeministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Çerkin Dukolli, deputetë të Kuvendit të Kosovës etj. Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, ka bërë me dije se këtë objekt do ta shfrytëzojnë 40 familje të kësaj komune. "Jam shumë i kënaqur pasi kemi arritur ta fillojmë ndërtimin e një qendre të këtillë përmes së cilës do ta sigurojmë strehimin për 40 familje.

Shfrytëzoj rastin që publikisht ta falënderoj ministrinë për këtë projekt, me rëndësi të madhe për ne", ka thënë Begaj. Qendra e Banimit Social është projekt dyvjeçar dhe është një projekt që bashkëfinancohet nga Komuna e Malishevës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku kjo e fundit e bartë pjesën më të madhe të financimit. Objekti i Qendrës së Banimit Social do të kushtojë rreth 650 mijë euro.

Konfiskohen produkte kozmetike dhe veshmbathje në Ferizaj

FERIZAJ, 21 TETOR (ER) - Inspektorati Komunal në Ferizaj ka konfiskuar disa produkte kozmetike dhe veshmbathje për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës. "Se Inspektorati Komunal i Ferizajt është kampion në rang republikanë në luftë kundër produkteve të dyshimta e dëshmojnë aksionet e përditshme me autorizimin dhe mbështetjen edhe të të parit të qytetit, Agim Aliu. Inspektorati Komunal po vijon aksionet në terren për kontrollin e produkteve që ofrohen në tregun e Ferizajt. Së fundmi, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës në Ferizaj kanë ndaluar një mjet transportues që po qarkullonte, i ngarkuar me mallra, përkatësisht produkte

kozmetike dhe veshmbathje ku, pas kontrollit, doli se ato nuk kanë dokumentacionin përcjellës që dëshmon origjinën e produkteve dhe destinimin, rrjedhimisht edhe u konfiskuan", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Sipas këtij njoftimi, Ridvan Berisha, koordinator i Inspektoratit Komunal, ka bërë me dije se aksione të tilla janë duke u zhvilluar çdo ditë dhe atë me të vetmin qëllim, garantimin e produkteve të sigurta dhe të verifikuara me dokumentacionin përcjellës që ofrohet në tregun e Ferizajt. Ai ka inkurajuar qytetarët t'i denoncojnë rastet e tilla në mbrojtje të ligjshme, luftimit të produkteve të dyshimta dhe sigurisë së produkteve në treg.



(Procesi Gjyqësor i Prizrenit më 1946. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: 6 veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg)

KOHA KUR SHQIPTARËT DËNOHESHIN ME PUSHKATIM



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Kur Kosova ende përpëlitej për jetë o vdekje, kur ajo ende nuk kishte dalë nga lufta, kur ende shumë gjëra nuk kishin kuptimësinë dhe rëndësinë e tyre të vërtetë, okupuesi dhe bandat e tyre ndjel-lakeqe, nguteshin që në atë kohë të mjegullt t'i qëronin hesapet me popullin liridashës shqiptar. Tamam ashtu edhe siç kishte porositur e paraparë Vasa Qubrilloviqi në elaboratet e veta 1-2, në të cilat thoshte se koha më e përshtatshme për t'i asgjësuar shqiptarët është koha e luftës dhe ditët e para, pas përfundimit të saj. Kështu edhe kishte ndodhur më 1945 e në vitet në vijim.

Ishte 27 shtatori i vitit 1945. Në Gjyqin Krahinor të Kosovës e Metohisë (kështu quhej atëherë Gjykata e Kosovës, shënim S. K-B). Në emër të popujve të Jugosllavisë, dolën para trupit gjykues dhe pritrnin t'u shqiptohet dënimi, 34 atdhetarëve. Tani nga kjo distancë kohore, të kapë tmerri vetëm të numërohet deri tek numri 34, e mos të flasim ata numra t'i shndërrosh në emra atdhetarësh, që në çdo moment pritej t'u shqiptohet dënimi, e ata assesi ta dinin se me çfarë vitesh të mëdha burgu do të përballëshin e dënoheshin.

Në një dosje, të ruajtur mirë nga arkivistët e Arkivit të Kosovës, me trishtim shpalosi faqe për faqe, dhe me drojë se mos diçka e rëndësishme do më të ikë, se diçka do të më shpëtojë pa e parë dhe pa e regjistruar ashtu siç duhej dhe siç e meritojnë atdhetarët e devotshëm të çështjes kombëtare. Lexoj me kujdesin më të madh dhe pa hezituar shënoi çdo detaj nga dosja.

Por, para se të ndalesha tek aktvendimi përfundimtar që e paraqet Gjykata Popullore Krahinore në Prizren, do të prezantoja tek procesi i arrestit dhe tek ngritja e aktpadisë që e ngre vetë Spasoje Gjakoviqi, që në atë kohë ishte major i OZN-së. Ai kishte urdhëruar që grupi i përbërë prej 34 vetave të arrestohet dhe të dalë para gjyqit. Ai i akuzonte se këta persona edhe para luftës, gjatë luftës dhe menjëherë pas përfundimit të saj, kanë kryer vepra penale që bien ndesh me popullin dhe shtetin.

Ngritja e aktpadisë nga Spasoje Gjakoviqi

Në ngritjen e aktpadisë ai shkruan se me vetëdije të lartë ky grup i

shqiptarëve formon organizatën ilegale Nacional Demokratike Shqiptare në Prizren, duke bërë organizimin në bazë të formimit të Komitetit Qendror si dhe të komiteteve të rretheve, qyteteve, komunave dhe duke i formuar edhe në të gjitha fshatrat ku kishte mundësi formimi. Gjakoviqi në aktpadinë e ngritur theksonte se faktori kryesor i tërë këtij aktiviteti pa dyshim se ishte tregtari i njohur nga Gjakova, porse jetonte në Kukës, Shqipëri, ishte Halim Spahija-Shaqiroviqi, (ai kishte harruar se emri i babait të Halim Spahisë ishte Shaqiri, e nuk kishte kurrfarë lidhje me shtesën e përdhunshëm "viq" (SK-B).

Mbi katërbëdhjetë faqe mbante aktpadina që sulmonte atdhetarët, por është befasuese se edhe më vonë në Prokurorinë Publike Popullore, porse edhe në Gjykatën Popullore Krahinore, nuk ndryshonin shumë aktakuzat dhe sulmet ndaj të burgosurve.

Në aktpadinë e Spasoje Gjakoviqit mungonte emri i Basrija Sallkoviqit, por në dokumentacionin e arkivit ruhej një shkresë tjetër me të cilën autorizohet Prokuroria Publike për Kosovë, me shkresën nr. 850, më 6. 9. 1945, që më vonë edhe ai të paraqitet në gjyq së bashku me grupin Nacional Demokratik Shqiptar. Edhe Sallkoviqi akuzohet se, sikurse shokët e vet, kishte kryer vepra "penale" e "armiçësore" ndaj popullit e shtetit të vet. Çfarë ironie, Jugosllavia ishte shteti i tij, sipas Gjakoviqit antishqiptar.

Nën 1. akuzohet se kishte pranuar kryerjen e detyrave nga Tahir Deda, për t'i formuar komitetet e rretheve të NDSH-së, në tërë Kosovën, si në Podujevë, në Prishtinë, në Ferizaj, në Gjiilan, në Kaçanik dhe në Lipjan. Sipas shënimeve që kishte arritur t'i siguronte Gjakoviqi, ai ishte i paraparë të jetë anëtar i Komitetit Qendror të NDSH-së në Prizren. Nën 2. edhe ky mban përgjegjësinë sikurse edhe të tjerët për aktivitetin e zhvilluar kundër-shtetëror.

Nën 3. kishte marrë pjesë aktive në formulimin e instruksioneve kryesore për punën e Komitetit Qendror, së bashku me Tahir Dedën, e sidomos kontribut të madh kishte dhënë në pikën ku flitej për lidhjet e komitetit me qetat ushtarake balliste që vepronin në male. Pason nënshkrimi i njëfarë oficerit të OZN-së, major, nënshkrimi ishte në çirilic, N. Jokiq (kështu disi).

Procedura e hetuesisë nga udbashët

Pas arrestimit të atdhetarëve, kishte filluar procedura e marrjes në pyetje të të burgosurve. Kjo etapë për të burgosurit ishte edhe periudha më e vështirë e burgut. Në këtë kohë të burgosurit njëri pas tjetrit merreshin në pyetje, por njëherë edhe ishte periudha kur

ndaj të burgosurve përdorej dhuna dhe torturat e ndryshme. Fillonin me kërcënime verbale për të kaluar në rrahje e deri në likuidimin fizik të tyre. Në hetuesi përdornin metoda të ndryshme duke i zgjuar me rrëmbim nga gjumi e deri në orët e imta të natës. Ndodhte edhe kjo kur i burgosuri kishte përfunduar hetuesinë në orën një pas mesnate dhe porsa rehatohej në qeli, ndodhte pas një ore të ndodhte që pesë e gjashtë gardianë vinin dhe e merrnin duke i thënë se hetuesia vazhdon. Shpesh ka ndodhur kur i burgosuri nga lodhja e raskapitja ka pranuar gjera që kurrë nuk i kishte bërë dhe as që kishte dëgjuar për to. Ose kur lodhej i burgosuri nga rrahjet e gardianëve, pa e lexuar fare i jepnin që ta nënshkruante deklaratën që ai në kushtet normale kurrë nuk do ta nënshkruante.



Duhet thënë se për një kohë shumë të shkurtër në hetuesi u morën të gjithë anëtarët e grupit që ishin arrestuar, u morën nga disa herë duke përdorur një arsenal të tërë torturash.

Në hetuesi i pari u mor i akuzuari Halim Spahia. Pesë herë u mor në pyetje duke mos llogaritur marrjen në pyetje për ta plotësuar hetuesinë si dhe ballafaqimin me të burgosurit e tjerë. Hera e parë që u mor në pyetje ishte më 6 korrik 1945, hera e dytë më 21 korrik 1945, hera e tretë më 25 korrik 1945, hera e katërt më 13 gusht 1945 dhe hera e pestë më 29 gusht 1945. Dhe disa herë ishte marrë për plotësimin e hetuesisë dhe kishte pasur një sërë ballafaqimesh me të burgosurit e tjerë, anëtarë të organizatës.


I arrestuari i dytë, Xhemil Fluku, katër herë ishte marrë në hetuesi. Edhe ky sikurse Halim Spahija kishte pasur plotësim të hetuesisë dhe ballafaqime me të burgosurit e tjerë. Fluku u mor në hetuesi më 2 e 4 korrik 1945 dhe më 27 gusht e 3 shtator 1945; Ahmet Dërguti merret 4 herë në pyetje. Në hetuesi u mor më 1, 2 e 3 korrik dhe 3 shtator 1945; Kajtaz Ramadani u mor në pyetje më 2 e 3 korrik 1945. Rifat Krasniqi u mor në pyetje dy herë. Më 9 korrik 1945 dhe 30 gusht 1945; Basri Sallkoviqi-Boshnjaku u mor në pyetje një herë, më 30 gusht 1945. Fehim Ibrahim u mor në pyetje më 9 qershor 1945; Abdullah Rexhepi u mor në pyetje tri herë, më 28 qershor 1945, më 2 e 3. 9. 1945; Ibrahim Feimi u mor në pyetje më 3. 9. 1945; Hasan Rustemiti u mor në pyetje 4 herë. Më 9. 7. 1945, më 13 korrik 1945, me 28. 7. 1945 dhe më 2. 9. 1945; Tahir Deda nga të gjithë të burgosurit u mor më së tepërmi në pyetje (mbi 16 herë). Për herë të parë u mor më 3, 4, 8, 9, 10, 13, 24. 27 korrik 1945, më 3, 6, 8 gusht 1945. Abdullah Hamza-"Palaço" u mor në pyetje 2 herë: më 1 korrik 1945 dhe më 25 gusht 1945; Sinan Hazëri u mor në pyetje më 1 e 4 korrik 1945. Kishte

vazhduar hetuesinë më 23. 8. 1945; Sefedin Ahmeti u mor tri herë në pyetje: më 27 korrik 1945, më 24 e 27 gusht 1945; Abdullah Hajrullahu u mor në pyetje më 30. 6. 1945, më 24. 7. 1945 dhe më 27. 8. 1945; Muhamet Veseli u mor në pyetje më 30. 7. 1945 dhe më 5. 8. 1945; Ibrahim Avdyli u mor në pyetje më 5. 6. 1945 dhe më 5. 8. 1945; Sadik Peqani u mor në pyetje më 6. 7. 1945; Qamil Jemini u mor në pyetje më 6. 7. 1945, më 5. 8. 1945; Maliq Bakija-Hoxha u mor në pyetje katër herë: më 3, 5, 22 e

30. 7. 1945, e 3 shtator 1945; Rexhep Abdullah Kabashi u mor në pyetje më 25 korrik 1945, më 3, 10 gusht 1945 dhe më 3. 9. 1945; Kadri Ramadani "Topalli" u mor në pyetje më 24 korrik 1945, më 6, 21 dhe më 28. 8. 1945. Në ballafaqim Laura dhe Kadri Ramadani-Topalli, mungon deklarata; Ruzhdi Kabashi merret në hetuesi më 10 korrik 1945, më 4. 9. 1945; Vahid Mustafa merret në hetuesi më 2 korrik 1945; Sheh Mujedini merret në hetuesi më 2 korrik 1945. (Vijon)



Çfarë kërkon ministri i jashtëm turk në Ballkan?



Shkruan: Bedri ISLAMI

Ministri i Jashtëm i shtetit turk është në rrugëtim e sipër në vendet shqipfolëse e mund të shkojë edhe më tej. Pas vizitës në shtetin shqiptar, si parashihej, ai shkoi edhe në Kosovë. Marrëdhëniet me shtetin turk janë të rëndësishme, megjithëse nuk ka pse të jenë strategjike të një rëndësie të veçantë. Megjithatë, kurdoherë, liderët politikë e shtetërorë të shtetit

turk kanë qenë e duhet të jenë të mirëpritur. Edhe kësaj here, zyrtarët e lartë të dy shteteve shqiptare bënë të gjitha përpjekjet për të dëshmuar se ndër-lidhjet tona, jo vetëm në fushën financiare, ku ato po marrin përparësi, ndoshta edhe tej parashikimit, janë të nivelit më të mirë të mundshëm dhe se nëpërmjet tyre mund të zgjidhen edhe probleme të tjera, që janë ende në pezullin e trajtimeve historike e politike. Edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë, ministri i Jashtëm turk kërkoj haptas, duke dëshmuar se këtë e kishte bërë edhe më parë zyrtarisht, që shtetasit turq në vendet respektive, Shqipëri dhe Kosovë, sipas listave që kishin dërguar, të deportohen në drejtësinë turke. Këtë ai e nënvizoi disa herë, saqë të dukej sikur ky ishte qëllimi

themelor i kësaj vizite. Shqipëria, e për më shumë Kosova, nuk ka pse bëhet pjesë e zgjidhjeve të halleve, trazimeve, përplasjeve dhe ballafaqimeve që ndodhin në Turqi e, aq më tepër, nuk duhet të bëhen vende ku, për hir të miqësisë private mes liderëve, të shkelen të drejtat dhe liritë e njerëzve, të cilët prej viteve jetojnë në vendet tona dhe nuk kanë shkelur asnjë ligj, nuk kanë bërë asnjë shenjë se janë të përfshirë në revolta apo grushte shteti të ndodhura në shtetin turk. Shembulli negativ i strukturave të Kosovës, duke deportuar tinëzisht disa mësimdhënës turq nga kolegjet e tyre, skenë makabre që i ngjante një filmi horror, nuk ka pse të përsëriten e as të mendohen se mund të ndodhin përsëri. Mund të ndodhë që, mes shte-

tasve turq që punojnë e jetojnë në Shqipëri apo në Kosovë, të ketë edhe ndonjë të përfshirë në organizatën FETO, e cila cilësohet si terroriste nga politika e tashme turke, apo të jetë, si i thonë tani, gulenistë, por askush nuk mund të paragjykohej në mungesën e tij, apo të deportohet sepse kështu qenka dëshira apo ka vendosur dikush në Turqi. Deportimi në shtetin turk, sipas një liste apo një kërkesë, do të ishte akt i turpshëm. Aq më tepër që, deri tani, gjithë të dhënat e strukturave perëndimore flasin dhe dëshmojnë për gjyqe të manipuluar, dhunë në burgje, ndjekje familjare, përgjime masive, krijim të dosjeve të rreme etj. Shteti shqiptar e ka për detyrë të interesohet edhe për shtetas të saj të cilët ishin të arrestuar pas grushtit të shtetit: studen-

të, ushtarakë apo punonjës të ndryshëm. Ai duhet të interesohet për fatin e tyre, të kërkojë t'i dijë shkaqet e arrestimeve, të kujdeset për pasurinë që kanë vënë ndershmërisht etj. Po ashtu, strukturat e shtetit të Kosovës, duke zënë mend nga deportimi i turpshëm disa javë më parë, duhet t'i mbyllin dyert nënshtrimit ndaj presionit të një shteti tjetër, pavarësisht prej lidhjeve miqësore presidenciale apo nga pakica turke në disa rrethina të saj. Ministri i Jashtëm turk erdhi, bisedoi, shkoi duke kërkuar haraçin e investimeve të shtetit të tij. Në dy çështje krejt të ndryshme, ajo që është thelbësore qëndron në dinjitetin e shtetit shqiptar për vetëdijesimin e tij, se edhe në këto kushte, themelore është liria e njeriut nga cili do vend që të ketë ardhur.

Në Kosovë janë paraqitur 225 raste të reja me kancer në gji



PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Në qendër të Prishtinës u mbajt marshi tradicional për luftimin e kancerit të gjirit me moton "Zbulimi i hershëm, mbi-jetesë". Ecja ka për qëllim ngritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë për rrezikun nga kanceri i gjiri dhe krijimin e

kushteve më të mira për zbulimin e hershëm dhe trajtimin optimal të kësaj sëmundje në Kosovë. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se duhet të ngrihet vetëdija dhe të bëhet diagnostikimi i kësaj sëmundjeje me kohë. "Nëse duam t'ia

shtrojmë vetes një pyetje se si mund të mbrohemi nga rreziku i kancerit të gjirit, është vetëm një përgjigje: 'diagnostifikimi sa më i hershëm'. Ka plot këtu në mesin tonë që e kanë mundur këtë sëmundje të keqe, por e kanë mundur ngaqë e kanë diagnostifikuar me kohë",

është shprehur kryeministri Haradinaj. Në tetëmujorin e parë të këtij viti në Kosovë janë paraqitur 225 raste të reja me kancer në gji, sipas të dhënave zyrtare nga Instituti Onkologjik në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Një yll i ri po i ngjitet skenës së muzikës

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Arioli është emri i talentit më të ri shqiptar. Arioli është producent, beatmaker dhe këngëtar i stilit më të ri të muzikës hip hop që quhet trap, një miksi i tekno e rap-it, lindur në vitet e '90 në USA, shumë i dashur për të rinjtë që duan diçka më të veçantë nga muzika. Pak e njohur në ambientin tonë muzikor, ku sundon muzika komerciale ballkanase, trap është stili më i të rinjve evropianë. Fjala trap vjen nga trap house, që do të thotë apartamente të braktisura ku përgatitej dhe shpërndahej droga në Atalante. Por sot muzika thuhet nuk identifikohet më me fillimet e veta. Arioli në këtë stil vjen original, duke sjell tone e tekste inspiruese. Novembre, Take me away, Fade star, janë singel të

tij në "YouTube", ndërkohë që është autor i beateve të disa grupeve italiane e amerikane. "Nuk bëj muzikë me të cilën janë mësuar njerëzit. Bëj muzikën që ma mëson mua ta jetoj jetën ndryshe nga ajo që ma imponon tregu. Nuk jam mall në shitje. E dua artin tim pa kompromis", ka thënë Arioli për mediet. Artisti rebel shquhet edhe për origjinalitetin në veshje, ku nuk bëhet një klon i stileve ekstravagante që sundojnë botën e trap e dubstep sot, por shfaqet i thjeshtë, si çdo moshatar i tij që injoron fake-luksin e rrjeteve sociale. Madje thjeshtësia e tij dhe mungesa e protagonizmit arrin kulmin në profilin e vet në "Instagram", ku shfaqet me emrin Drippinarioli dhe nuk poston thuhet asgjë nga muzika e tij.



Fjalim me rastin e përvitshorit të monumentit në fsh. Gllarevë, në nderim të heroit të kombit Haki Morina!

LARG KOSOVËS NË KROACI, LUFTOI KUNDËR TË NJËJTIT PUSHTUES SERBISË



Ismet SYLEJMANI

Shumë e dashura Nënë, motra dhe vëllezër të Dëshmorit të kombit Haki Morina!

Të nderuara familje të dëshmorëve, veteran e luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj!

Sot nderojmë figurën e dëshmorit të kombit Haki Morina, i cili që në moshë të fëmijërisë, dashurinë për Atdheun e kishte në zemër, sepse e kishte të trashëguar dhe të mbjellur nëpër breza nga fisi e në mënyrë të veçante prej atëhere kur në kullën e stërgjyshit të tij këtu në Gllarevë, ku është mbajtur kuvendi i madh i Llapushës në vitin 1919, nga ku dolën vendime të mëdha e që veçohet ai për t'ia ndalur hovin Serbisë! Ndikim të madh në formimin atdhetar e politiko-patriotik të Hakiut e vëllezërve të Tij, përpos përcaktimit dhe veprimat atdhetar të trungut familjarë, kanë pasur edhe dajtë nga Negroci e në mënyrë të veçantë ka pasur edhe veprimtari i madh kombëtar e ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Jakup Krasniqi, që është kushëriri i Nënës!

Hakiu bashkë me vëllezërit e tij, ka qenë pjesë aktive e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës e cila në vitin 1994 bëhet themeluesja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Populli shqiptar luftës për liri e çlirim ia ka dhënë bijat dhe bijtë më të mirë, por edhe lufta ia ka marrë më të mirët, me luftarakët, ata të çeliktët e i tillë, ndonëse i ri në moshë, thonë se ishte edhe dëshmori Haki Morina, të cilit po i përulemi dhe i bëjmë nderime sot!

Serbia pushtuese dhe aleatët e saj në ish-jugosllavi, republikat jugosllave, bijtë më të mirë e më të devotshëm, na i kanë shfarosur me çdo mjet e në çdo vend, mjafton të kenë vërejtur se ata kanë kurriz se nuk bëhen spiuj e tradhtar dhe nuk ia kthejnë krahët armikut!

Platforma antishqiptare e maltuseve serb shtrihej kudo e ngado që lëviznin shqiptarët.

Në çdo hap godiste hanxhari serb mbi burrat e kombit tonë, pa dallim moshën dhe pa dallim ideologjinë, mjaftonte të bindeshin se Atdheun e ka çështje mbi çështjet!

Gjakpirësit serb në ish-

Jugosllavi, luftën kundër popullit shqiptar e zhvillonin me çdo shqiptar që i kundërshtonte, që i luftonte e që nuk u bindej, të gjithë atyre ua vënë syrin dhe kudo që i kapnin i goditnin për vdekje, i masakronin, i vrisnin dhe ua dërgonin familjeve në shtëpi të shpuar nga rafalet e automatikëve dhe të sakatosur nga thikat dhe bajonetat e pushkëve dhe mjete të tjera torturuese!

Të tillë e kishte ardhjen në Atdheun e tij në Kosovë edhe Haki Morina, ndonëse jo edhe të ngjashme sikur të tjerët, sepse Hakiun e sollën në fshatin e lindjes, të vranë e të masakruar, të prerë e të ekzekutuar, e sollën tinëzisht, e sollën natën, se nata është terr, pasi natë e të zinj ishin edhe pushtuesit serb dhe veglat e tyre!

Shumë na kanë shkaktuar dhembje e vaj, tortura e dhunë, plagë e vrasje, varre dhe masakra, po krejt pushtuesit kudo nëpër botë kurrë nuk kanë qenë të mirë e nuk do të

jenë, por pushtuesit serb ishin më të pamëshirshmit, të gjitha të zezat na i bënë, por nuk arritën të na shfarosin as të na zhdukun.

Me asgjë nuk mundën me e ndërpre rrugën e luftës së armatosur çlirimtare!

Pushtuesit nuk lanë gurë pa lëvizur e mjet pa përdorur por të kotë e patën, sepse vëllezërit e dëshmorit të kombit Haki Morinës e të shumë shqiptarëve anë e kënd trojeve të pushtuara të Shqipërisë në Kosovë e vise, që erdhën në arkivole të blinduara se u vranë e u sakatosën barbarisht nëpër kazemat ushtarake jugosllave, të rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e të ushtrive çlirimtare, ua nxorën hakun vëllezërve të tyre, bënë luftë finale e frontale kundër policisë e ushtrisë serbe!

Aleatja e madhe e popullit shqiptar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me bombarduesit e saj në kuadër të Aleancës së NATO-s, por edhe aleatë të tjerë

të fuqishëm pro shqiptar, si Anglia, Gjermania, Italia, Franca etj., bombarduan Serbinë dhe kryeqytetin e saj Beogradin dhe objektet e veçanta e nevralgjike të funksionimit të aparatit antishqiptar por edhe të funksionimit normal të atij shteti famëkeq e vrasës për shqiptarët!

U dogjën në flakë e u shkatërruan krejtësisht nga bombardimet e NATO-s, Shtabi i Përgjithshëm i Armatës Jugosllave në Dedinje në Beograd, u bombardua fabrika e municionit dhe armëve në Kragujevac, u bombardua agjensia e lajmeve TANJUG në Beograd dhe shumë objekte vitale e të rëndësishme të veçantë! U bë realitet ëndrra e gjyshërve dhe baballarëve tanë, që në momente të përjetimeve të dhunës e tmerrit serb, ofshanin ah sikur të kishim mundësi ta bënim shkrumb e hi Beogradin! Dhe epoka e madhe e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e bëri realitet një ëndërr të tillë, Beogradi i Nikolla Pashiqit,

Beogradi i Aleksandër Rankoviçit dhe Beogradi i Milloseviçit, u bë shkrumb e hi, iu bombarduan urat e ngrohëtorja, iu bombarduan rrugët dhe nyjet, u kall në flakë Serbia pushtuese që në shekuj na dogji e na shkrumboi neve shqiptarëve të Kosovës e viseve të saja, na shpërnguli e kurrë nuk na e hoqi gazepin!

Vëllezërit e Hakiut, thonë se sikur të kishte qenë gjallë Hakiu, e ta kishte pritur luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të shndërrohej në një luftëtarë emblemë luani dhe komandant me nam!

Mendohet se i gjallë nuk do të kishte dalur nga lufta, por do të ishte njëri nga heronjtë dhe dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, prandaj ky monument është pak për këtë burrë të madh, por i bënë nderë jo vetëm Hakiut, por krahinës së tij dhe popullit shqiptar! Gllareva jote i dashur vëlla Haki Morina, ishte arenë e madhe e luftës së armatosur çlirimtare kundër pushtuesve serb e tradhtarëve të vendit!

Këtu armiku dhe eskadronët e vdekjes janë pritur me plumb e barot, pushkët dhe armët e çlirimtarëve kanë gjëmuar kudo kundër tyre, dhe Ti nga varri ke luftuar e ke kënduar, plagët tua në varr të kanë kulluar gjak por edhe në sytë tuaj, të janë derdhur lot nga gëzimi, sepse ke dëgjuar se si vëllezërit Tuaj të një nëne dhe ata të popullit shqiptarë, ushtarë e luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ta kanë marrë hakun, kanë vranë e kanë mitraluar pushtues, gjakësorë e kriminel paramilitarë serb!

Të nderuar të pranishëm!

Rënia e Hakiut është heroike, sepse ka rënë duke luftuar i vetëm kundër një ushtrie të tërë në Osojnik afër Dubrovnikut në Kroaci!

E ke gjatur vdekja të rrethuar nga ushtarë e paramilitarë serb, periudhë kjo kur artileria serbe granatonte e bombardonte qytetin e lashtë të Dubrovnikut! Prandaj shpallja dëshmor i kombit është nderim dhe respekt, mirënjohje e përulje, pasi edhe larg Kosovës, në Kroacinë aleatë të popullit shqiptar, luftoi kundër të njëjtit pushtues Serbisë!

Lavdi dëshmorit të kombit Haki Morina!

Lavdi të rënëve për liri!

Prishtinë, 20 tetor 2018!


(Autori është ish-anëtar i Komitetit Drejtues të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës!)



E rrallë

Meteori hënor shitet për 600 mijë dollarë në ankand

Një copëz hëne që ra në tokë si një meteor hënor, është shitur në një ankand për më shumë se 600 mijë dollarë. Një shtëpi ankan-desh në Boston ka njoftuar shitjen e meteoritit për 612.500 dollarë. Meteorit përbëhet nga gjashtë pjesë që kombinohen me njëra-tjetrën si një pazëll dhe ishte gjetur në Afrikë. Ai kishte



një peshë totale prej 5 kg dhe njihet si NWA 11789. Emri zyrtar është pazëlli hënor. Shtëpia e ankandeve kishte parashikuar se guri alien do të mund të arrinte 500 mijë dollarë në ankand.

BARSOLETA E DITËS



I dehuri: Sa kushton taksi deri në Prizren për dy persona?
Taksisti: Pse po pyet për dy persona kur ti qenke vetëm?
I dehuri: E ti nuk po vjen me mua a?




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
 Regjia: Albert Hughes

Vetem gjate vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
 Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
 Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
 Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
 Regjia: Ruben Fleischer
 Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

FOTO E DITES



Hallouini në Irlandë, festë "drithëruese"

E jashtëzakonshme

Kina do ta krijojë hënën e vet për t'i ndriçuar qytetet

Kina planifikon ta lansojë "hënën" e parë artificiale në orbitë, në mënyrë që t'i zëvendësojë dritat e rrugëve dhe t'i zvogëlojë kostot e energjisë. Shkencëtarët kinezë kanë thënë se hëna e bërë nga njeriu, e cila në thelb është një satelit i ndriçuar, do të jetë në orbitë në vitin 2020. Ajo do të jetë tetë herë më e ndritshme se hëna e Tokës dhe do të shkëlqejë në qytetin Chengdu,



kryeqyteti i provincës jugperëndimore Sichuan. Shpresohet se kjo risi që tingëllon si çmenduri kineze do ta zëvendësojë nevojën për ndriçimin e rrugëve dhe do t'i ulë kostot vjetore të energjisë elektrike deri në 1.2 miliard yuanë (173 milionë dollarë). Hëna do të ndriçojë vetëm një zonë prej 50 kilometrash, pasi është shumë më afër Tokës sesa hëna jonë reale.

 <p>DASHI Ky është momenti më i mirë për të pasur një ballafaqim konstruktiv me kolegët. Kjo ditë parashikon transaksione të rëndësishme financiare.</p>	 <p>DEMI Vini në lojë krijimtarinë tuaj pasi kjo është një periudhë shumë e mirë, sidomos në sferën profesionale. Në dashuri mos u bëni grindave.</p>	 <p>BINJAKËT Të gjitha fitoret e arritura në këtë çast do t'ju bëjnë krenar. Të gjitha sakrificat e bëra do t'ju shpërblehen.</p>	 <p>GAFORRJA Duhet të jeni shumë të matur me shpenzimet, sidomos nëse keni planifikuar një investim të rëndësishëm për shtëpinë.</p>	 <p>LUANI Do të jeni në kërkim të shumë përgjigjeve. Jeni të sigurt se çështjet e biznesit do të jenë mjaft të frytshme.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Nëse ndiheni të lodhur dhe të ngarkuar, kjo ditë do t'ju vendosë në provë, sidomos nga pikëpamja emocionale.</p>
 <p>PESHORJA Kjo është periudha më e frytshme në vendin e punës, merrni përsipër përgjegjësit. Siguria në veten tuaj do t'ju japë jetë edhe dashurisë.</p>	 <p>AKREPI Do të jeni mjaft të përkushtuar për realizimin e një projekti të ri i cili nuk do t'ju zhgënjë. Në mbrëmje parashikohen surpriza.</p>	 <p>SHIGJETARI Kjo ditë kërkon që të çoni përpara disa propozime dhe duhet të shfaqeni më të përgjegjshëm. Në dashuri merrni vendime të rëndësishme.</p>	 <p>BRICJAPI Keni mundësi ta gjeni stabilitetin dhe harmoninë në të gjithë raportet. Në dashuri do të ketë zhvillime pozitive. Edhe puna do të shkojë mirë.</p>	 <p>UJORI Këshillohet që të mendoni më shumë për veten dhe nevojat tuaja aktuale. Marrëveshjet do të jenë mjaft të favorshme.</p>	 <p>PESHQIT Me përqendrimin e duhur do të arrini të mbyllni me sukses një marrëveshje të re. Në dashuri nuk duhet të jeni shumë impulsiv.</p>

Bella me bikini "provokon" dimrin

Dimri po vjen në Los Anxhelos, por Bella Hadid po bën një lutje për pak më shumë diell dhe ka pasur një shans për të kapur disa nga rrezet e fundit. Modeluesja 22-vjeçare tregoi format e saj mahnitëse në dy foto të reja të publikuara në llogarinë e vet në "Instagram", ku ajo ka veshur bikini të vogla ngjyrë rozë dhe rehatohet në shezlong.




Luana Vjollca, me linja trupore të përkryera



Këngëtarja dhe moderatorja e njohur Luana Vjollca në profilin e vet në "Instagram" ka postuar një fotografi nga mbrapa, e veshur me një fustan ngjyrë rozë. Ajo çfarë vihet në pah është beli i saj i

hollë. Luana pa dyshim është një ndër moderatorët shqiptarë me linjat më të përkryera dhe që tërheq vëmendjen kudo që shkon. Luana është prezantuese e emisionit "Shiko kush luan".



Fustani tyl zbulon "asetet" e Rita Orës

Ajo është një popstare e talentuar që kujdeset gjithmonë për pamjen mahnitëse dhe stilin e veshjes. Rita Ora dukej sensacionale dhe shumë seksi pasi shijoi një "night-out" në Klubin e Annabel në Mayfair të Londrës. 27-vjeçarja me fustanin prej tyli nxori në pah asetet e saj teksa gjoksi shpërthyes nuk i shpëtoi vëmendjes së paparacëve. Por ngjyra e zbehtë dhe tejdukshmëria e fustanit bust e nxorën Ritën të zbuluar edhe në pjesën e belit të saj të hollë.



Ish-çiklistja sllovake shkëlqen si modele

Modeluesja 26-vjeçare sllovake, Lucia Javorcekova, një ish-çikliste, ka lënë biçikletën për t'iu përkushtuar modelingut dhe tashmë jeton në Milano, ku ka pozuar për kompani të ndryshme mode. Në një intervistë për një revistë mode, Lucia është shprehur se pasionin për biçikletën e ka zëvendësuar me pasionin për futbollin, teksa ka thënë se bën tifo për futbollistët sllovakë. "Ndjek shpesh ndeshje futbollit këtu në Itali. Hamsik është kapiteni i kombëtares,



por mua më pëlqen më shumë Skriniar. Më ka bërë tifoze të Interit, ndoshta edhe pse jetoj në Milano", ka thënë Lucia.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ARSENAL - LEICESTER

1

LENS - AJACCIO GFCO

3+

SPARTA PRAGUE - MLADA BOLES LAV

1

S'ka fitues në derbi. Gjilani befasoi Feronikelin

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 TETOR - Derbi i javës së 11-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll në mes të Trepçës '89 dhe Llapit përfundoi 1-1, ndërsa në ndeshjen tjetër të zhvilluar të dielën, Gjilani e befasoi Feronikelin, pasi e mposhti me rezultat 1-0. Kjo humbje nuk ndikoi që klubi nga Drenasi ta humbasë edhe pozitën e liderit, por ka bërë që diferenca e pikëve me skuadrat përcjellëse të jetë më e vogël. Fitores në këtë xhiro i është gëzuar edhe kampionia aktuale, Drita, që e mposhti Ferizajn me rezultat 0-2.

Trepça '89 - Llapi 1-1

Derbi i xhiros së njëmbëdhjetë në elitën e futbollit të Kosovës, mes Trepçës '89 dhe Llapit, përfundoi me rezultat 1-1. Ndeshja e zhvilluar në Mitrovicë ishte e tensionuar dhe gjyqtari kryesor shpërndau dy kartonë të kuq për secilin skuadër nga një. Në minutën e 17 Gucev Blagoj shënoi për 1-0, por mysafirët barazuan dhjetë minuta me vonë në 1-1. Në minutën e 36 Llapi mbeti pa një lojtar, pasi mesfushori Mentor Zhdrella u ndëshkua me karton të kuq. Në fund të pjesës së parë edhe golashënuesi i 89-shit, Gucev Blagoj, u përjashtua me karton të kuq. Në pjesën e dytë gola të tjerë nuk pati dhe ndeshja përfundoi me rezultat 1-1. Trajneri Bekim Shotani debuton me barazim si trajner i Llapit.

Gjilani - Feronikeli 1-0

Skuadra e Gjilanit e ka befasuar liderin e IPKO Superligës, Feronikelin, duke e mundur me rezultat 1-0. Kjo ndeshje i ka takuar xhiros së njëmbëdhjetë në elitë. Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0, kurse në minutën e 65-të Jefferson Lopes realizoi golin e fitores për vendësit. Pavarësisht prej kësaj humbje, "Nikli" mbetet në pozitën e parë me 23 pikë, kurse Gjilani ngrehet në pozitën e pestë me 17 pikë.

Ferizaj - Drita 0-2

Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Drita e Gjilani, e mposhti Ferizajn me rezultat 2-0. Në minutën e 31-të Betim Haxhimusa



realizoi pas një asistimi të Xhevdet Shabanit. Golin e dytë e shënoi në minutat shtesë zëvendësuesi Haxhi Neziraj, kurse u shërbye nga Xhevdet Shabani. Pas kësaj ndeshje Drita ka grumbulluar 16 pikë dhe zëvendimin e pestë në tabelë, kurse Ferizaj mbetet i dhjeti me 10 pikë.

Prishtina - KEK-u 3-0

Fitore me rezultat bindës shënoi edhe skuadra e Prishtinës, e cila përballë e kishte skuadrën më të dobët në ligë, KEK-un (3-0). "Elektricitet" rezistuan vetëm në pjesën e parë, pasi në pjesën e dytë sulmet e Prishtinës ishin të pandalshme dhe si rezultat i kësaj u realizuan edhe tre gola. Në minutën e 52-të Basit Khalid e hapi serinë e golave, kurse më pas realizuan Mario Morina (68'), dhe Mërgim Pefqeli (88). Tash skuadra e Prishtinës ka të grumbulluara 21 pikë, kurse KEK-u mbetet në kuotën e një pike.

Drenica - Liria 1-0

Drenica po vazhdon shkëlqimin në këtë kampionat, duke i tejkuluar pritshmëritë për rezultate pozitive. Kuqezinjët e Skenderajt u paraqitën mirë edhe në ndeshjen ndaj Lirisë, të cilën e mposhtën me rezultat 1-0, duke konfirmuar formën e lartë dhe grumbulluar 18 pikë. Liria kishte synuar t'u rikthehet rezultateve pozitive nga kjo ndeshje, por këtë gjë nuk e lejua vendësit që shënuan golin e fitores nëpërmjet Kreshnik Ukës në minutën e 39.

Ballkani - Flamurtari 1-0

Ballkani i Suharekës, pasi mori konfirmimin e mbështetjes nga

udhëheqësi dhe kryetari i klubit, arriti një fitore me rezultat minimal 1-0, ndaj një kundërshtari të papërshtatshëm siç është Flamurtari i Prishtinës. Manevski në minutën e 70 e realizoi golin e vetëm për skuadrën nga Theranda, kurse për Flamurtarin është humbja e dytë radhazi dhe ndeshjen e gjashtë pa fitore.

LISTA E GOLASHËNUESVE

Lojtari	Klubi	GOLA
1. Alban Shilova	(Flamurtari)	8
2. Festim Alidema	(Llapi)	7
3. Betim Haxhimusa	(Drita)	5
4. Mendurim Hoti	(Feronikeli)	5
5. Martin Mircevski	(Trepça '89)	5

IPKO Superliga

Trepça '89 - Llapi	1-1
Gjilani - Feronikeli	1-0
Ballkani - Flamurtari	1-0
Ferizaj - Drita	0-2
Drenica - Liria	1-0
Prishtina - KEK-u	3-0

Tabela

Rank	Klubi	Pikë
1.	Feronikeli	23
2.	Prishtina	21
3.	Llapi	20
4.	Drenica	18
5.	Gjilani	17
6.	Drita	16
7.	Flamurtari	16
8.	Trepça '89	15
9.	Ballkani	12
10.	Ferizaj	10
11.	Liria	9
12.	KEK-u	1

LIGA E PARË

Fushë Kosova - Vushtrria	0-2
2 Korriku - Bashkimi (K)	2-0
Drenasi - Istogu	3-0
Dukagjini - Besa	0-0
Onix - Vitia	0-0
Vëllaznimi - Vllaznia	2-1
Arbëria - Kika	2-1

Të hënën takohen:
Ramiz Sadiku - Trepça

Tabela

Rank	Klubi	Pikë
1.	Vëllaznimi	22
2.	Dukagjini	21
3.	Besa	21
4.	Vushtrria	20
5.	Arbëria	18
6.	Onix	16
7.	Vitia	15
8.	Trepça	13
9.	Drenasi	12
10.	Ramiz Sadiku	12
11.	Istogu	11
12.	Fushë Kosova	10
13.	2 Korriku	10
14.	Kika	9
15.	Bashkimi	6
16.	Vllaznia (P)	4

SHKURT

Immabile: Valon Berisha bëri diferencën

Ciro Immobile e ka vlerësuar shumë të vlefshme fitoren kundër Parmës (0-2) në udhëtim, ndërsa ka vlerësuar lart paraqitjen dhe ndikimin që Valon Berisha ka pasur në këtë ndeshje. "Kjo është një fitore shumë e vlefshme të cilën e kërkoi trajneri. Zëvendësimet e bënë diferencën dhe e ngritën ritmin e lojës. E rëndësishme që ekipi fitoi, dhe jo kush shënoi golat. Valon Berisha, që kishte pësuar një lëndim të rëndë, u kthye dhe bëri diferencën duke fituar penaltinë. Ai gjithmonë mund të mbështetet te ne", ka thënë Immobile për "Sky Sport Italia".

Rahoveci e mposhti Prizrenin

KB Rahoveci po vazhdon të paraqitet mirë në elitën e Kosovës në basketboll, kurse të dielën kjo skuadër e mposhti edhe Prizrenin me rezultat 101-99. Skuadra e Rahovecit është djersitur mirë për këtë triumf, por e ka regjistruar edhe fitoren e pestë në po aq ndeshje të zhvilluara. Fitores në këtë xhiro i është gëzuar edhe Prishtina që e mposhti Yllin (64-82), kurse Bashkimi e fitoi ndeshjen ndaj Lipjanit (82-77). E para në tabelë është Prishtina me dhjetë pikë sa ka edhe Rahoveci, Prizreni ka tetë pikë, derisa Ylli shtatë.

Shënon Dionis Avdijaj

Reprezentuesi i Kosovës, Dionis Avdijaj, ka shënuar Willem II, në ndeshjen e luajtur ndaj NAC Breda (2-2). Shqiptari shënoi një gol të bukur tre minuta pa përfunduar pjesa e parë e ndeshjes, për rezultatin 1-2. Ky ishte goli i katërt për Avdijajn në kampionat.

Henry debuton me humbje

Thierry Henry ka debutuar me humbje në krye të skuadrës së Monacos. Skuadra e Monacos të shtunën pësoi humbje nga Strasburgu me rezultat 2-1 në ndeshjen e kampionatit francez. Henry e zëvendësoi Leonardo Jarimin para shtatë ditësh, pasi Monaco i kishte fituar vetëm gjashtë pikë në nëntë ndeshjet e para.

Skënderbeu nuk gabon ndaj Kamzës

Skënderbeu ka marrë një fitore mjaft të vlefshme në shtëpi ndaj skuadrës së Kamzës. Korçarët triumfuan me rezultatin 2-0. Nuk ishte një sukses dhe aq i lehtë për të besuarit e Orges Shehit, të cilët hasën jo pak vështirësi kundër ekipit nga periferia e kryeqytetit. Në minutën e 12 Otto John realizoi për 1-0, kurse vetëm tre minuta më vonë mysafirët fituan të drejtën që të goditnin një 11-metërsh, por "Plaku" gaboi nga pika e bardhë, duke mos e gjetur as kuadratin. Edhe në fillimin e fraksionit të dytë ritmi ishte i ulët, por në minutat e fundit Kamza nisi që të provonte më shumë. Ishte vendimtar portieri i Skënderbeut, Aldo Teqja, vetëm 10 minuta para fundit të kohës së rregullt, pasi bëri dy pritje mjaft të vështira në pak sekonda. Vendësit në anën tjetër me qetësinë që u jepte rezultati, pritnin momentin e duhur për të rrezikuar. Bregu mendoi për të vulosur gjithçka pak sekonda para fundit, duke shënuar një gol mjaft të bukur nga goditja e dënimit.

Shkëndija triumfon mes racizmit ndaj Vardarit

Shkëndija e Tetovës fitoi një përballje të vështirë ndaj Vardarit në ligën e futbollit maqedonas, duke shtuar presionin te kryesuesit dhe rivalët për titullin. Ekipi shqiptar arriti t'i bëjë ballë presionit dhe koreve raciste për të shënuar nga një gol në çdo pjesë në Shkup. Izair Emini i dha avantazhin Shkëndijës mes protestave të vendësve nëse sfera kishte kaluar apo jo vijën fatale. Ky episod shkaktoi protesta dhe ndërprerjen e përkohshme të sfidës nën parullat ofenduese ndaj shqiptarëve, të ultrasve maqedonas. Por Ibrahim shënoi golin e dytë që vulosi gjithçka. Me suksesin e marrë, Shkëndija është vetëm 4 pikë larg Vardarit kryesues.

Marquezi mbron titullin në Moto GP

MOTEGI, 21 TETOR - Marc Marquez ia ka dalë me sukses ta mbrojë titullin kampion bote në Moto GP, pasi ka siguruar titullin kampion për vitin 2018, në saje të triumfit në garën e Motegit. Piloti spanjoll

i Hondës menaxhoi mjaft mirë garën, ndërsa përfitoi edhe nga fakti se rivali i tij kryesor, Andrea Dovizioso, gaboi dhe doli nga pista, pak xhiro larg fundit. Triumfi i Marquezit bëhet edhe më i bukur, pasi

vjen në garën e shtëpisë, për motorin që ai drejton, Hondën, ndërsa në Motegi u ngjiten në podium edhe Crutchloë e Rinsi, me Valentino Rossin që u rendit i katërti. Marc Marquez arrin kështu ta

fitojë titullin e pestë kampion në Moto GP dhe të shtatin duke llogaritur edhe ato në garat 125 CC dhe Moto2, ndërsa vlen të theksohet se kanë mbetur ende edhe tri gara që të mbyllet ky sezon.



Khaka tregon anën njerëzore: Nuk e harroj Julianin

LONDËR, 21 TETOR - Granit Xhaka ka treguar se di të jetë një person që "lufton" kundër të gjithëve. Në fushën e lojës ai paraqitet si një futbollist me profil të egër për shkak të ndërhyrjeve të ashpra dhe kartonëve, por jashtë saj ai është një person për t'u marrë shembull. Kur ka qenë pjesë e Gladbahut, mesfushori ka vizituar shpesh një fëmijë që vuan nga autizmi. Futbollisti i Arsenalit ka folur me të nëpërmjet linjës telefonike, pasi djaloshi i vogël është një tifoz personal i shqiptarit. E pranishme në takim ishte bashkëshortja e Granitit. Në një postim të shpërndarë në "Facebook" me video, Xhaka ka shkruar: "Nuk e harroj takimin e parë me Julianin kur luaja me Gladbah. Është fëmijë fantastik. Energjia



që ka për jetën është mësim për të gjithë ne. Ishte kënaqësi për gruan time, Leonitën, ta shihje atë. Po pres me padurim ta vizitoj shpejt. Bëhu i fortë burrë i madh".

Houstoni mposht Lakersat, grushte në fushë mes të Rondos dhe Paulit

HOUSTON, 21 TETOR - Tjetër humbje për Lakersin në kampionat, këtë herë në fushën e saj, ku në dy ndeshje të luajtura deri më tani ende nuk ka regjistruar asnjë fitore. Houstoni triumfoi 124-114 në Los Angeles, duke korrur fitoren e parë sezonale, ndeshje e shkëlqyer e James Hardenit, autor i 36 pikëve, mbështetur edhe nga Chris Paul me 28 pikë e 10 asistime. Për Lakersat u dallua LeBron Jamesi me 24 pikë, me 7 lojtarë të ekipit vendës që realizuan mbi 10 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Por kjo ndeshje pati një fund të shëmtuar, kur në shifrat 108-109 për miqtë, me 5 minuta nga fundi, plas një sherr



masiv në fushë, ku protagonistë janë Rajan Rondo për Lakers e Chris Paul për Houston. Pas debateve është Rondo ai që godet me grusht në fytyrë Paul, që reagon dhe në këtë sherr përfshihet edhe Ingram. Të tre këta lojtarë e mbyllin para kohe ndeshjen, por në fushë hyjnë stafet e dy ekipeve për t'i qetësuar gjakat, raporton "Telesport". Fitoren e dytë sezonale e korri Portlandin, që mundi 121-108 San Antonion, duke e nisur mjaft mirë kampi-

onatin (Lillard 29 pikë e McCollum 24). Tri fitore në tri ndeshje të luajtura për Toronton, skuadra më e mirë për momentin në NBA, me kanadezët që triumfuan 117-113 në fushën e Washingtonit (Lowry 28 pikë e 12 asist). Fiton edhe skuadra e Bostonit, që mundi 103-101 New Yorkun në sekondat e fundit, falë 24 pikëve e 14 rebaundeve të Tatumit, ndërsa Detroiti fitoi 118-116 ndaj Chicagos, ndeshje ku u dallua Griffin me 33 pikë e 12 rebaunde.

SHKURT

Istogu e mposhti bindshëm Shqiponjën

Edhe një derbi i fituar thellë nga skuadra e Istogut, e cila e mposhti Shqiponjën e Gjakovës me rezultat 40:25. Ndeshja e luajtur në palestrën "Karagaçi" në Pejë ishte derbi i xhiros së pestë të Superligës për hendbolliste. Pas pjesës së parë skuadra istogase ishte në epërsi me rezultat 21:15. Për Istogun ishte fitorja e katërt, ndërsa për Shqiponjën humbja e parë kampionale. Kapitenia Rugova ka shkëlqyer duke realizuar 15 gola për Istogun. Nëntë herë shënoi Ferataj. Për skuadrën gjakovare dhjetë gola i shënoi Mehmeti.

Messi mungon tri javë, nuk luan në "El Clasico"

Ylli i Barcelonës, Lionel Messi, do të mungojë për tri javë pas lëndimit që pësoi në kraharor në fitoren e skuadrës së vet ndaj Sevillës të shtunën. Argentinasi la fushën qysh në pjesën e parë pasi kishte rënë keq në fushë, pas përplasjes në ajër me Franco Vazquezin. Messi u largua në minutën e 26, ndërsa deri në ato çaste ndihmoi me një gol dhe asistim. Messi la fushën në kohën kur rezultati ishte 2 me 0, ndërsa në fund Barça fitoi 4 me 2. Pas takimit Barcelona konfirmoi "thyerjen e kockave radiale në kraharor e djathtë". Tani ai pritet të mungojë në Ligën e Kampionëve ndaj Interit në mesjavë dhe në "El Clasico" ndaj Realit të dielën e ardhshme.

Kololli shënon ndaj Young Boysit

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Benjamin Kololli, po tregon formë të lartë këtë sezon me skuadrën e Zurichit. Zurichu ka barazuar me rezultat 3-3 ndaj liderit të kampionatit, Young Boysit, në ndeshjen e vlefshme për javën e 11-të në Superligën e Zvicrës. Në këtë ndeshje shenjë ka lënë edhe ylli i Kosovës, Kololli, i cili ka shënuar për vendësit. Goli i Kolollit erdhi në minutën e dhjetë të ndeshjes dhe i dha epërsinë 2-0 ekipit të tij. Ky gol u shënuar nga pika e bardhë dhe ishte vetë lojtari i Kosovës i cili e nxori atë pas një ndërhyrje në të brenda zonës.

Realit shumë shpejt me trajner të ri

Duket se Lopetegui po kalon orët e fundit si trajner i Realit të Madridit. Sipas së përditshmes "AS", bëhet me dije se Antonio Conte do të vijë në vendin e vet. Resali u mund 1-2 në shtëpi nga Levante dhe ky rezultat ishte fundi për spanjollin. Megjithatë javën e ardhshme do të luhet Barcelona - Real Madrid, çfarëdo rezultati të marrë trajneri, duket se fatet e tij janë caktuar. Gazeta spanjolle thekson se Perezzi është takuar me Conten që pas humbjes që Realit pësoi në Moskë.

Wilderi synon 60 % të shumës nga përballja me Joshuan

Boksieri amerikan Deontay Wilder, kampion bote në peshën e rëndë në kategorinë WBC, ka deklaruar se kërkon 60 % të fitimit në duelin ndaj britanikut Anthony Joshua në rast se më 1 dhjetor ai arrin të mund një tjetër boksier ishullor, Tyson Fury. Shifra prej 60 % do të jetë maksimalja që Wilderi do të kërkojë, por është gati të negociojë dhe ta ulë kërkesën deri në një ndarje të barabartë 50-50 për ta zhvilluar këtë duel, që do të unifikonte titujt kampionë bote të peshës së rëndë. "Pas duelit dhe fitores që do të arrij ndaj Furyt, në mendjen time është një ndarje 50-50 ose 60-40 të fitimit në favorin tim për t'u përballur me Joshuan. Unë kërkoj 60-40 pasi e meritoj, por për t'i kënaqur fansat, që e duan këtë duel, jam gati të pranoj edhe një ndarje të barabartë të të ardhurave në 50-50. Nuk do të ulem asnjë për qind më shumë nga kjo shifër", u shpreh Deontay Wilder.

NBA

Indiana - Brooklyn	132-112
Washington - Toronto	113-117
New York - Boston	101-103
Philadelphia - Orlando	116-115
Chicago - Detroit	116-118
Miami - Charlotte	112-113
Dallas - Minnesota	140-136
Denver - Phoenix	119-91
Portland - San Antonio	121-108
Lakers - Houston	115-124



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit- Kancelarija Premijera-Office Of The Prime Minister
